



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Komuna e Obiliqit - Opština Obilič - Municipality Obiliq



Zyra e Kryetarit
Kabinet Predcednika/ Office of the Mayor

Datë/Data/Date:	15 Korrik 2024
Nga/Od/From:	Kryetari i Komunës z.Xhafer Gashi
Për/Za/To:	-Kryesuesen e Kuvendit Vlora Mjekiqi –Kabashi -Anëtarët e Kuvendit Komunal
Tema/Subjekat/Subject	Raporti Janar –Qershor 2024

Përshëndetje e nderuara Kryesues ,
Të nderuar anëtar të Kuvendit Komunal

Ju lutem që në mbledhjen e Kuvendit Komunal në muajin Korrik ta shqyrtoni :

**RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS DHE EKZEKUTIVI KOMUNAL PËR
PERIUDHËN JANAR –QERSHOR 2024**

Ky raport është ndarë në tre pjesë :

-Raporti i ekzekutivit

-Raporti i DEFZH

-Raporti i zyrës së prokurimit .

Ju faleminderit për bashkëpunim !

2024



KOMUNA OBILIQ
OPSTINA OBILIQ
MUNICIPALITY OBILIQ

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS DHE EKZEKUTIVIT KOMUNAL

 REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO 
KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OBILIC
Nr. Br. No. 02-104/02-2024/24
Nr. i fq. / Br.str. / No.pg. 1-1
Data / Datum / Date 16. 07. 2024.
OBILIQ - OBILIĆ - OBILIC

Janar –Qershor 2024

FJALA HYRËSE E KRYETARIT TË KOMUNËS

XHAFER GASHI

.....

Qytetarë të Obiliqit ,

Anëtar të Kuvendit ,

Si rezultat të punës gjashtë mujore të angazhimit maksimal në shërbim të qytetit dhe fshatrave , ju paraqes raportin gjashtë mujor për vitin 2024 .

Raport ky i projekteve dhe të arriturave dhe sfidave të cilat na presin së bashku ! Raport ky që së bashku hartuam buxhet , mbikëqyrëm së bashku dhe së bashku ju gëzuam investime

Ky raport pasqyron angazhimet tona të përbashkëta për aktivitetet , arritjet, sfidat dhe planet për të ardhmen e qytetit tonë.

Raporti gjashtë i punë sonë është mjet i rëndësishëm për transparencën tonë të plotë dhe llogaridhënien para jush .

Risi për vitin 2023 dhe 2024 ishte edhe forma e re e hartimit të buxhetit ‘ Buxhetimi me pjesëmarrje ‘ , formë kjo që u realizua në fshatin Mazgit.

Kurse për vitin 2024 është realizuar në pesë lokalitet : Obiliq ,Milloshevë ,Breznicë, Mazgit dhe Dardhishtë

Kemi vazdhuar me investimet kapitale ne infrastrukturë, arsim, shëndetësi , kulturë , rini sport etje ..

Bashkëpunimi me Institucionet Qendrore , donatorët , e organizata tjera i vazhdueshëm .

Parteritet me USIAD , OSBE , DEMOS , Ambasadat ,Bankën Botërore ,BE-në .

Të nderuar anëtar të Kuvendit Komunal së bashku me ju kemi arritur që planin e hartuar të punës ta realizojmë dhe buxhetin e planifikuar ta menagjojmë ne mënyrën me të mrë të mundëshem Po ashtu ju kemi raportuar ne baza tre mujore për gjendje financiare dhe ky raportin gjashtë mujor .

Përmbledhje

Fjala e Kryetarit	2
Drejtoria e Administratës së Përgjithëshme- DKRS –	4 09
DREJTORIA E ARSIMIT - DSHMS -	17 32
Drejtoria e Inspekcionit DSHPE –	50 51
DMM –	53
DBZHR -	55
Drejtoria e Infrastrukturës Lokale – DPUPK –	57 59
Njësia e Burimeve Njerëzore –	65
Zyra ligjore -	67
Njësiti Antidiskriminim dhe Barazi Gjinore	69

DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHM

HYRJE	4
SEKTORI I ADMINISTRATES SE PERGJITHSHME	5
KUVENDI KOMUNAL	5
DËGJIMET PUBLIKE	Error! Bookmark not defined.
ARKIVA	Error! Bookmark not defined.
QENDRA E SHERBIMEVE PER QYTETARËT	5
LOGJISTIKA	6
TEKNOLOGJIA INFORMATIVE	6
SEKTORI I GJENDJES CIVILE	8
PROJEKTET E DREJTORISË SË ADMINISTRATËS	9

HYRJE

Drejtoria e Administratës në kuadër të kompetencave të saj dhe në përputhshmëri me legjislacionin dhe aktet normative në fuqi, ka kryer punët administrative jo vetëm në shërbim administrative për qytetarët e komunës së Obiliqit.

Duke pasur parasysh të gjitha përgjegjësit, Drejtoria e Administratës gjatë vitit të lamë pas në mënyrë profesionale është kujdesur që të jenë sa më pranë qytetarëve të Komunës së Obiliqit., duke tentuar të gjejë zgjidhje për çdo çështje të adresuar pranë kësaj Drejtorie.

Duke qenë se në vazhdimësi po tentojmë të përmisojmë shërbimet tona, në hyrje të objektit të komunës, kemi vendosur kutinë e ankesave dhe kutinë e lëvdatave, ku në këtë mënyrë qytetarët kanë mundësi të na ndihmojnë që të kryejmë një punë profesionale. Përkushtimi ynë që shërbimet administrative për qytetarët të jenë sa më të shpejta, drejtoria e Administratës së Përgjithshme ka funksionalizuar E-kioskun në Komunën e Obiliqit të cilat shërbime ofrohen çdo ditë çdo 24 orë. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, ka thelluar përkushtimin për t'ju sjellë eksperiencën më të lehtë dhe efikase të mundshme në marrjen e shërbimeve komunale. Për këtë qëllim, kemi funksionalizuar platformën tonë të re të aplikimeve online, tani ju keni mundësinë

të aplikoni për shërbimet tona nga komoditeti i shtëpisë tuaj, pa pasur nevojë të vizitoni zyrat tona ose të pritni në radhë.

Në këtë raport vjetor, jemi munduar të përfshijmë të gjitha detyrat e Drejtorisë së Administratës gjatë vitit 2024, të ndara nëpër sektorët përkatës.

Në vijim gjeni raportet e detajuar për secilin sektor.

SEKTORI I ADMINISTRATËS SE PËRGJITHSHME

Sektori i Administratës kryen të gjitha punën profesionale, juridike të Kuvendit dhe Komuniteteve obligative dhe mbikëqyrë punët në QSHQ(Qendra e Shërbimit për Qytetarë).

Ky sektor përgatit të gjitha vendimet sipas kërkesës së Kryetarit të Komunës, prokurimit dhe njërive kërkuese, si dhe kthen përgjigje në të gjitha kërkesat e qytetarëve të drejtuar Kryetarit dhe bordit të drejtorëve.

Në kuader të këtij sektori janë Kuvendi, Qendra për Shërbim me Qytetar, Arkiva, Logjistika dhe Teknologjia Informative.

KUVENDI KOMUNAL

Kuvendi Komunal në këtë 6 - muhor ka mbajtur 8 (shtate) mbledhje, prej tyre 6(tri) të rregullta dhe 1(një) seance solemne dhe 1 (një) mbledhje te jashtëzakonshme.

Komitetit për Politik dhe Financa ka mbajtur 6 (gjashte) seanca ;

Komitetit për Komunitete ka mbajtur 6 (gjashte) seanca ;

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) ka mbajtur 3(tri)mbledhje.

Gjatë kësaj Kuvendi Komunal ka miratuar 24 vendime, 1 Rekomandim dhe 3 Rregullore .

Gjithashtu në kuadër të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme bëhet edhe përkthimi shqip-serbisht dhe anasjelltas i të gjitha materialeve për KK-se , komiteteve obligative , rregulloreve, vendimeve, konkurseve dhe materialeve tjera sipas kërkesës se drejtorive.

QENDRA E SHËRBIMEVE PER QYTETARËT DHE ARKIVA

Sa i përket QSHQ(Qendra e shërbimit për qytetarë) dhe arkives, janë kryer punët e përditshme në pranim-dorëzimin e kërkesave të qytetarëve, dhënia e informacioneve qytetarëve, ndihma dhe këshilla e nevojshme për realizimin e kërkesave dhe ankesave të tyre si dhe protokollimi i lendeve te brendshme. Dorëzimi i lendeve për palët dhe institucionet e jashteme-240 ndërsa nga posta e jashtme i kemi evidentuar 606 lende.

Këto punë (lëndë) kryhen përmes intranetit dhe librave përkatëse, ku për periudhën raportuese paraqesim statistikën sipas programit, si më poshtë:

- pranuar–**15** lëndë;
- në proces-**2,897** lëndë;
- të miratuara–**6,610** lëndë;
- të refuzuara–**322** lëndë;
- të hedhura poshtë – **17** lëndë;
- të pezulluara – **3** lëndë;
- të ceduara -**25** lëndë;
- të anuluarat-**33** lëndë;
- të përfunduara–**8,357** lëndë;
- Gjithsej –**18,271** lëndë.

Sa i përket sistemit Intranet, afati dhe shqyrtimi i kërkesave është 30 ditë, mirëpo meqenëse drejtorinë përkatëse në Komunën e Obiliqit, çdo vit ndajnë subvencione të natyrave të ndryshme, është e pamundur që të gjitha kërkesat të shqyrtohen brenda afatit të sistemit.

LOGJISTIKA

Nga zyrtarja e logjistikës në Drejtorinë e Administratës, janë realizuar Hyrje-Dalje nga depoja për administratën komunale, institucionet arsimore si dhe institucionet shëndetësore. Po ashtu janë realizuar kërkesat për material administrativ hyrje-dalje në sistemin E-pasurisë gjithashtu edhe hyrjet në thesar, për të gjitha lëndët e prokurimit në shume prej 28,733.13 €.

TEKNOLOGJIA INFORMATIVE

Gjate kësaj periudhë në sektorin e IT janë bërë 96 formatizime dhe instalime për kompjuterët e ri dhe janë bërë intervenime tek institucionet komunale shëndetësi arsim si dhe shkollat e komunës si dhe janë bërë shumë punë tjera duke përfshirë krijimin në SIMBNJ 185 kyçje në sitëm dhe 254 qasje në HRMIS SYSTEM .

Nga lëmi e servisimit të pajisjeve të IT janë servisuar shumë pajisje duke pasur problem me rrym dhe kanë shkaktuar dëme në pajisje të IT-së janë djegur 18 Power suplai (pajisje të furnizimit me rrym)

Janë bërë incizimet e mbledhjeve të kuvendit si dhe transmetimi drejt përdoruesve me teleprezencë në MAPL dhe kam bërë edhe kyçjani në CMS ,

Në web faqe postimi i Rregulloreve të cilat nuk kanë qenë të postuara në CMS dhe dizajni i ballinës dhe shumë ndryshime në CMS (Content Management System) dhe CSS dhe konfigurimi, dizajni i ri dhe shtimin e raporteve në secilën drejtori ,

Lëshimin në punë të sistemit të ri të intranet në QPS menaxhimin e sistemit të shumta në Qendrën për punë Sociale

Janë regjistruar 25 pasuri në SIMFK

Janë bërë 9 kërkesa për kyçje në kamera dhe nxjerrja e incizimeve nga Prokuroria e Shtetit

Dhe kam qenë i angazhuar edhe nga inspektorati për mbrojtjen e të dhënave personale që të bëhet verifikimi i disa kamerave në Bizneset e Komunës sonë pasi që kanë shkelur privatësinë dhe shkeljen e mbrojtjen e të dhënave personale .

Çdo aktivitet që ka pas komuna kam qenë i angazhuar me zërim.

Transmetimi i Mbledhjeve On-line në Web

Angazhuar në punë dhe në komisione të ndryshme

Menaxhim të kontratave .:

Vlen të cekë se kemi probleme me energji elektrike dhe si pasojë e këtij problemi më është djegur serveri UPS qendror i Serverve Dell Power Edge 2950 dhe tani është kthyer në sistem mirëpo kemi ca probleme pasi që rryma po shkakton shumë probleme dhe po kemi pengesa edhe në punët e përditshme pasi që rryma po i djeg Power Suplai .

Aplikacionet komunale në të cilën bëj Administrimin e tyre .

1. Intranet

2. E-arkiva

3. E-pasuria

4. Simbnj

5. SMVP

6. Domenin Mun.Gov.irk.rks

7. CMS

8. Free Balancë Web Aplikacion

9. Sistemin e MPB për riatdhesim

- 10. Softwerin për Përkthim donacion nga USAIDI
- 11. Menagjimin e të dhënave personale i caktuar nga ASHMDHP (MPB) gjithsej 56 raste
- 12 Menaxhimin e softuerit për Hapjen dhe caktimin e orarit te dyerve për hyrje dhe dalje
- 13 HRMIS SYSTEM
- 14 HRIS sistemin e menaxhimit të fermerëve , Subvencionimin ,LPIS
- 15 Sistemin në Kadastër KCID, KCLIS,
- 16 Quick Box sistemin e menaxhimit të financave,
- 17 Obilqionline shërbime Online
- 18 SIMFK Moduli i Pasurisë
- 19 E-kioskën

Ndërsa ne QKMF menaxhimin e SISH Aplikacionit

Ne Arsim kemi E-Shkollën i cili eshë duke u ber analiza për fillimin dhe implementimin nga MASHT ,ne kemi qen ne fazën e testimave kemi qen ne shkollat ku eshë ber testi dhe eshë ber qe te shikohet dhe a mundemi te shikojmë a mundemi te fillojmë implementimin e tyre ,

SEKTORI I GJENDJES CIVILE

Në zyrën e Gjendjes Civile gjatë periudhës janar-qershor/2024 janë kryer të gjitha detyrat sipas përgjegjësive të nëpunësve civil dhe ligjeve në ku fuqi, ku gjithsej janë dorëzuar:

Në këtë zyre gjatë muajit janar –qershor 2024, janë lëshuar:

Ekstrakt lindjes	7675
Certifikata të lindjes	2071
Certifikata te martesës	1403
Certifikata te vdekjes	471
Certifikata te vendbanimit	283
dekleratat e bashkësisë familjare	884
Certifikata e gjendjes martesore	250
Certifikata e shtetësisë	72
Vërtetim nga arkiva	65
Gjithsejtë	13174

PROJEKTET E DREJTORISË SË ADMINISTRATËS

Nga Drejtoria e Administratës së Përgjithshme për këto periudhe projekte të reja.

Të gjitha të dhënat më lartë, janë të bazuara në raportet e sektorëve përkatës të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, në përputhje me detyrat zyrtare të nëpunësve civil brenda Drejtorisë.

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT



DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Obiliqit, gjatë gjashtëmuorit të parë punës, ka përfunduar aktivitetet të planifikuara në kuadër të Planit vjetori të Punës për vitin 2023, bazuar në kompetencat, objektivat dhe synimet e përgjithshme të drejtorisë duke udhëhequr me resurset (burimet) lokale kulturore, sportive e rinore të Komunës së Obiliqit.

Në këtë raport gjashtëmuor (janar-qershor) të punës janë të përfshira aktivitetet dhe projektet e zhvilluara në drejtori, në fushën e kulturës, sportit dhe rinisë.

Personeli i DKRS-së, ka bërë përpjekje maksimale në kuadër të kompetencave të drejtorisë, duke përmbushur planin e punës, qëllimet dhe objektivat për vitin 2024 dhe ka rezultuar me sukses në aktivitetet e realizuara gjatë kësaj periudhe.

Aktivitetet e DKRS-së për periudhën raportuese të gjashtëmuorit të parë Janar-Qershor 2024:

✓ *Përgaditja dhe hartimi i Planit të Punës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2024*

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport duke u bazuar në synimet dhe objektivat e përgjithshme, ka hartuar një Plan të pasuruar të Punës për vitin 2024, duke planifikuar një sërë aktivitetesh kulturore, artistike, sportive e rinore, të cilat do realizohen në bashkëpunim me OJQ-të e komunës së Obiliqit. Personeli i DKRS-së, do të bëjë përpjekje maksimale në kuadër të kompetencave të drejtorisë, duke përmbushur planin e punës, qëllimet dhe objektivat për vitin 2024.

✓ *Formimi i Këshillit Organizativ për organizimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara sipas Planit të Punës së DKRS-së për vitin 2024*

Me vendim të Kryetarit të Komunës, është formuar Këshilli Organizativ për organizimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara sipas Planit të Punës së DKRS-së për vitin 2024, me qëllim të bashkërendimit, koordinimit të mirëfilltë në realizimin sa më të suksesshëm të aktiviteteve.

✓ *Kontrollimi i raporteve të projekteve të subvencionuara nga DKRS-ja nga viti paraprak*

Zyrtarët e DKRS-së, kanë pranuar raportet financiare dhe narrative të ojq-ve kulturore, sportive e rinore që kanë qënë përfituese nga thirrjet publike për subvencionim gjatë vitit 2023.

✓ *Përgaditja e planit të prokurimit dhe planit të shpenzimit për projektet në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.*

✓ *Mbikëqyrja profesionale dhe teknike për fillimin e sezonit për të gjitha klubet sportive:*

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, është përkujdesur për realizimin e të gjitha përgaditjeve në Palestrën Sportive “Adem Jashari” që për klubet sportive të krijohen kushtet sa më të përshtatshme për realizimin e stervitjeve, ndeshjeve miqësore e kampionale.

✓ *Orari vjetor për stërvitje të klubeve sportive:*

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, është përkujdesur për përpilimin e orarit të stërvitjeve të klubeve sportive që realizohen në Palestrën Sportive “Adem Jashari”.

✓ *Shpallja e Thirrjes Publike për subvencionim nga DKRS-ja për vitin 2024*

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, në kuadër të kategorisë së subvencionimit, për vitin 2024 ka planifikuar vlerën prej 130 mijë euro, ku përmes kësaj thirrje publike iu ofrohet mbështetje financiare të gjitha organizatave jo-qeveritare kulturore, sportive, rinore si dhe individëve të regjistruar në Republikën e Kosovës, që veprojnë në komunën e Obiliqit, programi i të cilave është i fokusuar në ruajtjen e traditës kulturore, fuqizimin dhe avancimin e të rinjëve dhe sportit. Thirrja publike me **Nr.14-660/11-7682/24**, ka qenë e hapur për aplikim nga data 15 mars 2024 deri me datë 29 mars 2024.

✓ *Organizimi i takimeve me OJQ-të, sportive, kulturore e rinore*

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, si çdo fillim vit, ka organizuar takime me OJQ-të, klubet sportive e shoqatat kulturore që veprojnë në komunën e Obiliqit, në këto takime u njoftuan nga afër me Planin e Punës së drejtorisë për vitin 2024, për mundësit e bashkëpunimit në realizimin e objektivave të përbashkëta përgjatë vitit, me qëllim të rritjes së aktiviteteve por dhe nxitjes së pjesëmarrjes së të rinjëve në aktivitete kulturore, rinore dhe sportive.

✓ *Shënimi i 16- vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës*

Për nder të 17 Shkurtit- Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, nën përkujdesjen e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport është shënuar kjo ditë me një sërë aktiviteteve;

- Ceremonia e homazheve pranë Pllakës Përkujtimore të Dëshmoreve të Kombit në Sheshin e qytetit të Obiliqit.
- Ceremonia e homazheve në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.
- Nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, nën përkujdesjen e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, është organizuar kjo ditë feste me dy pjesë:
Pjesa e parë: Manifestimi qendror kulturor-artistik, për nder të 17 Shkurtit, në bashkëpunim me Gjimnazin “17 Shkurti” dhe Ansamblin e Qytetit.

Pjesa e dytë: Koncerti festiv i Ansambllit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve “Shota” dhe Ansambllit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve Popullore të Shqipërisë.

✓ ***Shënimi i 8 Marsit- Ditës Ndërkombëtare të Gruas***

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, është përkujdesur që përmes dhurimit të një lule trëndafil të gratë në administratën komunale, në statcionin policor në Obiliq, përfaqësueset nga KFOR-i LMT, mjekët dhe infermieret, mësueset, të shënoj Ditën Ndërkombëtare të Gruas, duke theksuar se themelet e një familje, shoqërie dhe institucioni janë gratë.

✓ ***Akademi përkujtimore në 25 vjetorin e rënies së Dëshmoreve të Familjes Rama***

Nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, nën përkujdesjen e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, është shënuar 25 vjetorit i rënies së Dëshmorëve të Familjes Rama, përmes Akademisë Përkujtimore, duke nderuar jetën dhe veprën dhënë për liri e shtetndërtim, nën prezencën e familjes Rama, familjeve të Dëshmorëve e Martirëve të lirisë, Shoqatave të Dalura nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, deputetë të Kuvendit të Kosovës, Komandantit të Statcionit Policor, asambleistë, ekzekutivi dhe bashkëqytetarë. Kjo Akademi u përcoll me një dokumentar dhënë për sakrificën e Dëshmorëve të Familjes Rama dhe pika artistike nga nxënës të SHFMU “Dr.Ibrahim Rugova” dhe artistit Hysni Klinaku.

✓ ***Garat Komunale me shkollat***

Në kuadër të kalendarit të garave sportive, DKRS-ja në bashkëpunim me DKA-në dhe Shoqatën e Pedagoqeve ,kanë organizuar garat komunale në:

- Sportin e Basketbollit,
- Sportin e Hendbollit,
- Sportin e Volejbollit

✓ ***Akademi përkujtimore në 25 vjetorin e rënies së Dëshmorit të Kombit Ferid Curri***

Në 25 vjetorin e rënies së Dëshmorit të Kombit, Ferid Curri, nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Obiliqit dhe nën përkujdesjen e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, me Akademi Përkujtimore kujtuam dhe nderuam jetën dhe veprën dhënë për liri e pavarësi, nën prezencën e familjes Curri, familjeve të Dëshmorëve e Martirëve të lirisë, Shoqatave të Dalura nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, bashkëveprimtarët e bashkëluftetarët e Dëshmorit, deputetë të Kuvendit të Kosovës, Kryetarin e KBI-së në Obiliq, Kryesusen e KK Obiliq, asambleistë, ekzekutivin dhe bashkëqytetarët. Akademia u përcoll me këngë të kënduara për heroizmin e Dëshmorit Ferid Curri, nga Daim Zeqiri dhe nipat e Sefë Mleqanit ku dhe promovuan videoklipin e këngës "Zjarrët e lirisë" kushtuar Dëshmorit Ferid Curri.

✓ ***Kampionati shtetëror i Karates U-17***

Në Palestrën Sportive "Adem Jashari", u mbajt Kampionati shtetëror i Karatesë për grupmoshat 7-U14, organizuar nga Federata e Karatesë së Kosovës, me pjesëmarrjen e 49 ekipeve nga të gjitha komunat e Kosovës e nikoqir i këtij organizimi ishte Komuna e Obiliqit përkatësisht Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

✓ ***Shënimi i 5 Majit- Ditës së Dëshmorëve të Kombit***

Nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi dhe nën përkujdesjen e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport përmes një Akademie Përkujtimore është shënuar 5 Maji- Dita e Dëshmorëve të Kombit. Në Akademi janë ndarë mirënjohje për familjet e Dëshmoreve dhe Martirve të Lirisë si dhe u përcoll më një recitim skenik nga Teatri i Qytetit dhe me përgaditje artistike nga Ansambli i Qytetit.

✓ ***Shënimi i Javës Aerounatike të Kosovës- “Kastriot Open 2024”***

Në bashkëpunim me Klubin e paragllajding-ut “Shqiponjat e Kastriotit”, në Obiliq, është shënuar Java Aerounatike e Kosovës “Kastriot Open 2024” e cila ka filluar nga data 26 Maj 2024 deri me datë 02 Qershor 2024, një javë të mbushur me përplot aktivitete kreative që ndërldihen me këtë sport si dhe nën pjesëmarrjen e tetë (8) shteteve të botës dhe nën pjesëmarrjen e katërdhjetë e shtatë (47) pilot të talentuar.

✓ ***Shënimi i 1 Qershorit- Ditës Ndërkombëtare të Fëmijeve***

Për nder të 1 Qershorit – Ditës Ndërkombëtare të Fëmijeve, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, është përkujdesur të realizoj aktivitete në bashkëpunim me OJQ-të dhe akteret institucional te artit, kësisoj:

- ***Aktiviteti me Maskota për fëmijët:*** në bashkëpunim me Qendrën Rinore, është realizuar festivali me maskota për fëmijët, në amfiteatrin e sheshit të qytetit të Obiliqit.
- ***Shfaqja premiere “PITER PAN”:*** në bashkëpunim me Baletin Kombëtar të Kosovës, në Shtëpinë e Kulturës “Xhavit Haziri” në Obiliq, u dha shfaqja premier “PITER PAN” e Baletit Kombëtar të Kosovës.

✓ ***Shënimi i 14 Qershorit – Ditës së Çlirimit të Komunës së Obiliqit***

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Obiliqit, z.Xhafer Gashi, ka shënuar aktivitete të shumta kulturore dhe sportive në shënimin e 14 Qershorit – Ditës së Çlirimit të Komunës së Obiliqit, duke organizuar aktivitetet si në vijim:

- ***Shënimi i 11 Qershorit – Krisma e parë e Lirisë në fshatin Hamidi***, 11 qershor 1998 shënon Krismën e parë të lirisë në trevat tona, tani e 26 vite pas, nderuam heronjtë e trimat të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke nisur kështu Javën e Çlirimit në Komunën e Obiliqit. Aktiviteti u shënuar nën pjesëmarrjen e drejtorëve të ekzekutivit, drejtoreshës së Gjimnazit dhe një grupi nxënësve (gjeneratë e Pavarësisë), të cilët patën rastin që përmes një kronologji të ngjarjeve dhënë nga Profesori i Historisë, z.Gazmend Mirena, të njohin përpjekjet shekullore, ngjarjet e ditës 11 qershor 1998 e deri tek kurorëzimi i çlirimit të vendit.
- ***Promovimi i librit “Stina e Luleve”***, në shënimin e Javës së Çlirimit, u promovua libri "Stina e Luleve", përmbledhje poezish nga grup nxënësish dhe përgatitur për botim nga Profesoresha njëherit dhe autore znj.Sanije Ahmeti Dubova, duke shënuar kështu Ditën e Poezisë në Obiliq.
- ***Premiera e shfaqjes "Lufta e Gruas" nga Teatri i Qytetit***, në kuadër të aktiviteteve për Javën e Çlirimit në Komunën e Obiliqit, u dha premiera e shfaqjes "Lufta e Gruas" nga Teatri i Qytetit.
- ***Ceremonia e homazheve pranë Pllakës Përkujtimore të Dëshmoreve të Kombit***, në Sheshin e qytetit.
- ***Manifestimi Qendror për nder të Ditës së Çlirimit***, Dita e Çlirimit u përmyll me Manifestimin Qendror në Shtëpinë e Kulturës “Xhavit Haziri”, nën prezencën e Kryetarit të Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, Kryesueses së Kuvendit Komunal, asambleistëve, ekzekutivit, përfaqësuesve të SHDL-së, familjarëve të dëshmorëve dhe martirëve, përfaqësuesve të KBI-së, qytetarëve dhe përfaqësuesve të institucioneve lokale. Manifestimi u përcoll me poezi nga Teatri i Qytetit, me këngën “Ai është i Gjallë” nga artistja e re Alena Xhota, këngë patriotike nga artisti Vesad Mjeku, si dhe me pika artistike nga Ansambli i Këngëve dhe Valleve “AKV Qyteti i Obiliqit”.
- ***Turniri tradicional i Boksit***, në amfiteatrin e Sheshit të Qytetit, është mbajtur turniri tradicional i Boksit, në bashkëpunim me Klubin e Boksit “Kastrioti- Obiliq” dhe Federatën e Boksit të Kosovës, nën pjesëmarrjen e 28 boksierëve.

Aktiviteti në objektet nën administrimin e DKRS-së:

✓ Shtëpia e Kulturës “Xhavit Haziri”

Në Shtëpinë e Kulturës “Xhavit Haziri” janë realizuar aktivitete kulturor-artistike, njëkohësisht janë mbajtur ushtrimet e rregullta nga AKV “Qyteti i Obiliqit” dhe ushtrimet skenike e teatrale të Teatrit të Qytetit, aktivitete të tjera nga OJQ-të e Komunës së Obiliqit, shfaqje të baletit nga shkollat e baletit “Pirouette”, “Let’s Dance”.

✓ **Palestra Sportive “Adem Jashari”**

Në Palestrën Sportive “Adem Jashari”, janë realizuar stërvitjet e rregullta të klubeve, ndeshjet miqësore dhe aktivitete të tjera sportive, nuk ka pasur asnjë ndërprerje të aktiviteteve gjatë kësaj periudhe.

✓ **Biblioteka e Qytetit**

Në Bibliotekë e Qytetit ka vijuar puna e rregullt, njëkohësisht, kemi bashkëpunuar me dashamirës të librit: mësimdhënës, nxënës, shkrimtar , në mënyrë që të kemi ngritje të vetëdijes rreth lexshmërisë.

Në nderim të të rënëve për liri e shtet ndërtim, Drejtoria për Kulturë ka organizuar:

- Ceremoni të homazheve për nder të Epopesë së UÇK-së, 5-6 dhe 7 Mars, pranë “Pllakës Përkujtimore të Dëshmorëve” në Sheshin e qytetit dhe në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.
- Ceremoni të homazheve në nderim të “Dëshmoreve të familjes Rama, Martirëve të familjes Halimi dhe Haliti”.
- Ceremoni të homazheve në nderim të të rënëve të familjes Morina, pranë Pllakës përkujtimore në Milloshevë.
- Ceremoni të homazheve në nderim të “Dëshmorit Ferit Curri”, pranë lapidarit në fshatin Mazgit.
- Ceremoni të homazheve në nderim të “Dëshmorit Fejzullah Grajçevci”, pranë Pllakës Përkujtimore në fshatin Graboc.
- Ceremonia e homazheve në nderim të Dëshmorëve të Kombit- Shënimi i 5 Majit “Dita e Dëshmorëve të Kombit” , pranë Pllakës Përkujtimore të Dëshmorëve në Sheshin e Qytetit “Dëshmoret e Kombit”.
- Ceremoni të homazheve në nderim të “Dëshmorit Murat Krasniqi”, në Stanoc.
- Ceremoni të homazheve pranë “Pllakës Përkujtimore të Dëshmorëve”, në fshatin Siboc.
- Ceremoni të homazheve pranë në nderim të “Dëshmorit Hasan Hasani”, pranë varrit në fshatin Mazgit.
- Ceremoni të homazheve te “Martirët e familjes Aliu”, pranë Pllakës Përkujtimore në fshatin Milloshevë.
- Ceremoni të homazheve për “Dëshmoret e rënë në Betejën e Hades”.

Shënim: Gjatë këtij gjashtëmujori (6) të punës, janë ndërmarrë veprime të tjera të cilat nuk janë të listuara në raport, janë diskutuar dhe komentuar aktivitete dhe ide të ndryshme që i përkasin sektorit të tashëgimisë, janë realizuar raporte të shumta përmbledhese për infrastrukturën fizike sportive, kulturore dhe rinore sipas kërkeses së Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, janë realizuar takime me akteret të shumtë duke përfshirë takime me zyrtar nga MKRS-ja si dhe me përfaqësuesit e KFOR-it LMT K9 zviceran.

Numri i nxënësve për vitin shkollor 2023-2024

Nr.	Shkolla	Shqiptarë			gjithsej			Ashkali			Romë			Serbë			gjithsej		
		Mashkull	Femër		Mashkull	Femër	gjithsej	Mashkull	Femër	gjithsej	Mashkull	Femër	gjithsej	Mashkull	Femër	gjithsej	Mashkull	Femër	gjithsej
1	"Rrita Jonë"	36	44	80	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	36	44	80
2	"Fazli Grejçevci" - Hade	24	12	36	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	24	12	36
3	"Fazli Grejçevci" - Palaj	19	27	46	0	0	0	9	11	20	0	0	0	0	0	0	28	38	66
4	"Fazli Grejçevci" - Lajthishtë	45	42	87	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	45	42	87
5	GJIMNAZI,,17 SHKURTI"	98	179	277	0	0	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	98	180	278
6	"Hasan Prishtina"	294	258	552	0	0	0	14	9	23	0	0	0	0	0	0	308	267	575
7	"Hasan Prishtina"-1	42	34	76	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	42	34	76
8	Migjeni- Siboc	83	67	150	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	83	67	150
9	Migjeni-Graboc I Eperm	18	18	36	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	18	18	36
10	SHFMU "Naim Frashëri" Breznicë	92	98	190	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	92	98	190
11	SHFMU "Naim Frashëri" Kozaricë	32	35	67	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	32	35	67
12	SHFMU "Abdurrahmon Gërguri" Dardhishtë	58	63	121	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	58	63	121
13	SHFMU "Dr.Ibrahim Rugova" Obiliq	453	457	910	0	0	0	10	9	19	0	0	0	0	0	0	463	466	929
14	SHFMU "Dr.Ibrahim Rugova" Mazgit I Lartë	80	76	156	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	80	76	156
15	SHFMU "Dr.Ibrahim Rugova" Mazgit I Ulët	120	112	232	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	120	112	232

16	SHFMU "Pandeli Sotiri" Obiliq I Vjetër	100	93	193	0	0	0	2	3	5	0	0	0	0	0	0	102	96	198
17	SHFMU "Pandeli Sotiri" Plemetin	20	16	36	0	0	0	76	62	138	0	0	0	0	0	0	96	78	174
18	SHMLP "Ismajl Dumoshi" Obiliq	254	81	335	0	0	0	3	1	4	0	0	0	0	0	0	257	82	339
19	SHFMU" Sveti Sava" Plemetin	0	0	0	0	0	0	0	0	0	91	107	198	37	31	68	128	138	266
20	SHFMU" Millan Rakiq" Babimost	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	32	32	64	32	32	64
21	SHFMU"Dositej Obradoviq" Palaj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	24	26	50	24	26	50
22	SHMLP" Sveti Sava" Plemetin	0	0	0	0	0	0	0	0	0	20	41	61	40	30	70	60	71	131
	Gjithsej	1868	1712	3580	0	0	0	114	96	210	111	148	259	133	119	252	2226	2075	4301

DREJTORIA E ARSIMIT

Drejtorja e Arsimit në gjashtëmuorin e parë të 2024, punët dhe detyrat i ka kryer në bazë të Planit të Punës për vitin 2024 dhe detyrat tjera, të cilat janë marrë nga DKA dhe MASHTI. Janë mbajtur takimet e rregullta me Bordin e Drejtorëve Komunal, drejtorët e institucioneve arsimore, Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, punëtorët e DKA-së dhe takimet me OJQ-të për projektet e arsimit.

Nga nëpunësit civil të DKA-së janë hartuar planet e punës për vitin 2024. Gjatë muajit janar janë kryer vlerësimet e punëtorëve për vitin 2023 në Sistemin e Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBN-HRMIS), ku nota mesatare e vlerësimit të nëpunësve për detyrat dhe aktivitetet është 4.9. Janë vlerësuar edhe drejtorët e zëvendës drejtorët e SHFMU dhe SHML, ku nota mesatare e vlerësimit për vitin 2023 është 4.43.

Organizimi i procesit mësimor në gjysmëvjetorin e parë dhe të dytë

Arsimi në Komunën e Obiliqit organizohet në katër nivele 0,1,2,3 në këto fusha: Menaxhimi i arsimit; Gjithëpërfshirja dhe ngritja e sigurimit të cilësisë; zbatimi i kurrikulës së re; mjedisi i shkollës dhe zhvillimi i arsimit profesional. Shkollat mësimin e zhvillojnë, jo vetëm në klasa, por edhe në punëtoritë për praktikë profesionale (SHMLP), kabinetet e informatikës, kabinetet e fizikës, kimisë dhe biologjisë duke përdorur vazhdimisht mjetet didaktike, që kanë shkollat.

Me ndërtimin e sallave të edukatës fizike, ora e edukatës fizike zhvillohet për shtatë shkolla në kushte bashkëkohore. Mësimdhënësit dhe nxënësit orët e mësimit nga fusha e kurrikulës edukatë fizike, sportet dhe shëndeti i zhvillojnë në salla të edukatës fizike. Gjysmëvjetori i parë i vitit shkollor 2023-2024 ka përfunduar më 12.01.2024. Gjysmëvjetori i dytë ka filluar më 25.01.2024 (sipas Udhëzimit Administrativ të MASHTI-it nr.21/2023). Gjysmëvjetori i dytë ka përfunduar më 16 maj 2024 për klasët e 12 -ta, më 6 qershor për klasët e 9, 10 dhe 11-ta. Më 24 qershor 2024 për klasët 1-8 dhe fëmijët për parashkollor.

Numri i nxënësve është 4301 sipas komunitetve: shqiptarë janë 3578, serbë 252, romë 259, ashkali 210 dhe boshnjakë 2. Janë 247 paralele, 19 paralele me parafillor me 228 paralele 1-5, 6-9 dhe 10, 11 dhe 12.

Numri i punëtorve të arsimit në qershor 2024 është 403 punëtorë, prej tyre 10 drejtorë, 2 zëvendësdrejtoër, 318 mësimdhënës, 1 sekretare, 3 psikologe, 1 logopede, 6 asistente për fëmijët nxënësit me nevoja të veçanta, 2 administratë, 54 punëtorë teknikë, 4 bibliotekarë dhe 2 serviruse. Numëri i punëtorëve ndryshon gati çdo muaj për shkak të pushimeve të lehonisë dhe pushimeve tjera.

Nr.	Institucionet Arsimore	Drejt or	Zv.drejt or	Biblioteka rë	Pedago g sekretar	Psikolog e logoped e	Asisten të	Admin i.	P.tekni kë	Mësimdhën ës	Servis uese	Tota li	M	F	M	F
1	IP"Rrita Jonë"	1						1	1	9	2	14	0	14		14
2	"Dr.Ibrahim Rugova"	1	1	1	1	2	3		10	76		95	19	76	19	80
3	"Hasan Prishtina"	1	1			1	1		7	39		50	14	36	14	36
4	"Pandeli Sotiri"	1					1		7	25		34	10	24	10	25
5	"Naim Frashëri"	1							4	26		31	12	19	12	19
6	"Migjeni"	1		1					3	25		30	15	15	15	16
7	"Abdurrahmon Gërguri"	1							2	14		17	3	14	3	15
8	"Fazli Grajqevci"	1					1		3	31		36	7	29	7	30
9	"17 Shkurti"	1							2	14		17	6	11	6	11
10	"Ismail Dumoshi"	1		2		1		1	7	38		50	25	25	25	25
11	"Sveti Sava"									12		12	5	7	5	7
12	"Dositej Obradoviq"								2	4		6	4	2	4	2
13	"Milan Rakiq"								6	5		11	4	7	4	7

Gj		10	2	4	2	4		2	54	318	2	403	124	279	12	28
															4	7

Gjatë kësaj periudhe janë bërë pagesat për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit për nxënës dhe nxënës me nevoja të veçanta, për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, bursave të nxënësve me sukses të shkëlqyeshëm për shkollat e mesme të larta dhe studentëve të nivelit baçelor dhe master për vitin shkollor dhe akademik 2023-2024.

Subvencionet e DKA-së për vitin shkollor dhe akademik 2023-2024

Nr.	Ndarja e subvencioneve	Numri i konkurruesve	Numri i përfituesve	Mjetet e ndara	Meshkuj përfitues të subvencioneve	Femra përfituese të subvencioneve
1	Bursa për nxënës të SHML me sukses të shkëlqyeshëm	101	81	14,580.00 €	28	53
2	Bursa për studentë të nivelit baçelor	227	176	111,300.00	39	137
3	Bursa për studentë të nivelit master	66	51	5,100.00 €	15	36
4	Bursa të nivelit të doktoraturës	1	0	0	0	0

5	Kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit për nxënës me nevoja të veçanta	36	36	28,890.00 €	21	15
6	Kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit për nxënës të SHFMU dhe SHML	944	764	103,140.00 €	338	426
Gj:		1339	1108	308,910.00 €	441	667

Studentja Shqiponjë Rama në Fakulteti Ekonomik ka pasur notën më të lartë gjatë studimeve dhe ka fituar çmimin “Adem Preniqi” në vlerë prej 1,400.00 €.

Komuna e Obiliqit, Drejtira e Arsimit për vitin shkollor 2023-2024 organizon transportin edhe për një numër të nxënësve në vlerë prej 16,921.92 € për nxënës që jetojnë në Zonën e Interesit Nacional, të shpallur nga Qeveria e Republikës së Kosovës(Hade dhe Graboc).Në Shpitullë janë 10 nxënës që barten në SHFMU”Migjeni“ në Graboc dhe 2 nxënës janë në Hade, që vijojnë mësimin në ShFMU ”Fazli Grajqevci “ në Palaj. Transporti organizohet edhe për nxënës që janë të rrezikuar në komunikacion, të cilët janë të lagjes Mavriqi - Hade e Re, ku janë 9 nxënës. Për transportin e nxënësve shqiptarë dhe serbë janë edhe dy minibusa të komunës, të cilët bartin nxënësit nga Babimoci, Llazareva dhe Lagjja e Grajqevci në Obiliq, në ShFMU”Hasan Prishtina “ në Milloshevë. Nga vendbanimi Babimoc barten 100 nxënës, nga Llazareva 30 nxënës, nga Lagjja Grejqevci 40 nxënës dhe nga Njana Voda në Palaj në ShF”Dositej Obradoviq” barten edhe 23 nxënës serbë vetëm në një ndërrim (kthehen pas mësimit).

Planifikimi i projekteve të DA-së dhe planet e prokurimit për vitin 2024

Nr	Shkolla	Vendi	Projektet (datat e parapara për prokurim)	Relizimi nga DA
1	SHMLP“Ismail Dumoshi”	Obiliq	Ndërtimi i Aneksit të shkollës në SHMLP”Ismail Dumoshi” në Obiliq (projekti do të vazhdojë gjatë vitit 2024)	DA
2	Institucionet Arsimore	Obiliq, Milloshevë, Raskovë, Mazgit, Plemetin, Hade, Palaj, Lajthishtë, Siboc, Graboc , Breznicë , Kozaricë, Dardhishtë dhe Babimoc	Material higjenik për shkolla (shkurt 2024)	DA
3	IP”Rrita jonë” dhe DKA	Obiliq	Ushqim dhe pije për IP”Rrita jonë” dhe DKA (shkurt –dhjetor 2024)	DA
4	Institucionet Arsimore	Obiliq, Milloshevë, Raskovë, Mazgit, Plemetin, Hade, Palaj, Lajthishtë, Siboc,Graboc , Breznicë , Kozaricë, Dardhishtë dhe Babimoc	Dru dhe pelet nëpër shkolla (mars 2024)	DA
5	Institucionet Arsimore	Obiliq, Milloshevë, Hade, Siboc, Graboc, Breznicë, Kozaricë, Dardhishtë dhe Babimoc	Kabinetet për shkolla (matematikë,gjeografi, histori dhe edukatë fizike) (prill 2024)	DA
6	Institucionet Arsimore		Blerja e dy minibusëve (për transportin) të nxënësve të shkollave të komunës (shkurt- mars 2024)	DA
7	Institucionet Arsimore	Obiliq	Digjitalizimi i SHMLP “Ismail Dumoshi”dhe Gjimnazit “17 Shkurti “ në Obiliq (17.03.2023)	DA
8	SHFMU”Naim Frashëri “ në Breznicë	Breznicë	Ngritja e një pllake falenderimi në SHFMU”Naim Frashëri “ në Breznicë (prill 2023)	DA
9	ShMLP “Ismail Dumoshi”	Obiliq	Paisje për punëtori në SHMLP”Ismail Dumoshi “ në Obiliq (2024)	DA

10 ShFMU "Dr. Obiliq
Ibrahim Rugova
"

Projekti " Shtruarja e dysHEMEVE të klasëve të
shkollës dhe salsportive
me epoxit në SHFMU"Dr.Ibrahim Rugova " në
Obiliq

Donacion nga
Qeveria Japoneze-
Ambasada
Japoneze në
Kosovë

Janë relizuar dhe janë nënshkruar kontaatat për këto projekte:

Material higjenik për shkolla, material administrativ për IA, ushqim dhe pije për IP "Rrita jonë " në Obiliq, " Shtruarja e dysHEMEVE të klasëve të shkollës dhe salla sportive me epoxit në ShFMU "Dr.Ibrahim Rugova " në Obiliq (ka filluar projekti) dhe projekti dru dhe pelet për institucionet arsimore. Po vazhdon faza e dytë e projektit "Ndërtimi i Aneksit të shkollës" në ShMLP "Ismail Dumoshi" në Obiliq (projekti po vazhdon nga vitit 2023). Blerja e dy minibuseve për transportin të nxënësve të shkollave të komunës" janë blerë dy kombibusë. Projekti "Rregullimi i nxemjeve qendrore nëpër shkolla" (I përfunduar), Kabinetet për shkolla (matematikë, gjeografi dhe histori) për të cilin është nënshkruar kontrata.

Projekti për fazën e parë të digjitalizimit të shkollave është në procedura të përgatitjes.

Konkurset e rekrutimit gjatë periudhës gjashtëmuajore 2024

Janë publikuar shtatë (7) konkurse, prej tyre dy të rregullta për vendet e punës: Mësimdhënës për biologji në ShMLP "Ismail Dumoshi" në Obiliq dhe mësimdhënës për filozofi –sociologji në Gjimnazin "17 Shkurti" në Obiliq dhe katër rishpallje për vende të lira të punës për mësimdhënës për fizikë ,kimi dhe një punëtor teknik në ShMLP "Ismail Dumoshi " në Obiliq dhe një kuzhinierë në IP "Rrita jonë " në Obiliq. Për disa shkolla janë mbajtur intervistat, testet me shkrim dhe intervistat verbale.

Janë përzgjedhur shtatë (7) punëtorë në IEA: një sekretare në ShFMU "Dr.Ibrahim Rugova" në Obiliq,një mësuese klase në ShFMU"Pandeli Sotiri " në Obiliq dhe një punëtor teknik në ShFMU "Abdurrahmon Gërguri " në Dardhishtë; një mësimdhënëse e biologjisë, një mësimdhënëse e kimisë dhe një punëtorë teknike në ShMLP"Ismail Dumoshi "në Obiliq " dhe një kuzhinjere në IP "Rita jonë" në Obiliq. Konkursset për një mësimdhënës të filozofisë -sociologjisë në Gjimnazin "17 Shkurti " në Obiliq dhe një punëtor të Teknologjisë Informative janë anuluar dhe do të rishpallen.

Më 10.06.2024 është publikuar konkursi për IP"Rrita jonë" në Obiliq për pranimin e 19 fëmijëve për plotësimin e vendeve të lira për fëmijë.

Menaxhimi i programit të intranetit

Në programin e intranetit gjatë gjatëmuajve të parë të këtij viti janë regjistruar 506 kërkesa të palëve e kërkesa nga arkivi komunal, janë pranuar të gjitha , prej tyre të miratura janë 408 kërkesa, të refuzuar 45,të anuluar 3, të transferuara në drejtoritë tjera 10 dhe në proces janë 40 , kryesisht kërkesa të palëve dhe nga arkivi komunal, të cilat janë në shqyrtim .

Trajnimet: Gjatë muajit shkurt 2024 është kryer trajnimi i mësimitdhënësve për robotikë. Më 03.04.2024 DA dhe drejtorët e IEA kanë mbajtur takim punë me përfaqësuesin e projektit KosEd, z.Robert Blease dhe është vendosur që të bëhet marrëveshja mes DA

dhe KosEd për ngritjen e cilësisë së arsimit përmes projektit vlerësimi nga kolegët dhe vlerësimet e brendshme e të jashtme të shkollave .Ky projekt do të fillojë nga fundi i shtatorit apo fillimi i tetorit 2024 në shkollat fillore të mesme të ulta.

Garat e diturisë 2024 Janë mbajtur garat e fizikës dhe matematikës në nivel të shkollave , komunës dhe vendi.

- Është mbajtur Testi TIMS 2024
- Më 22.06.2024 në dy qendra është mbajtur Testi i Maturës Shtetërore 2024 me klasë të 12 –ta.
- Më 25.06.2024 është mbajtur pjesa e parë e Testit të Arritshmërisë 2024 me klasë të 9-ta
- Më 28.06.2024 është mbajtur pjesa e dytë e Testit të Arritshmërisë 2024 me klasë të 9-ta Për të gjitha testet e qershorit rezultatet do të publikohen në fillim të muajit korrik.

Projektet dhe aktivitetet e Drejtorisë së Arsimit

1.Më 05.06.2024 ka filluar punën grupi për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal të Arsimit 2025-2029.Këtë projekt e mbështet dhe e ndihmon Qendra për Arsimin e Kosovë(KEC).

2.Hartimi i Rregullores komunale nr .01-2024,datë 04.03.2024 , sipas vendimit 01/060-01-6552-24,datë 04.03.2024 .Nga Komisioni komunal është hartuar :”Rregullore për organizimin e punës në shkollat fillore të mesme të ulta dhe të mesme të larta,udhëheqësit,mësimdhënësit,nëpunësit profesional,mbështetës,nxënësit dhe mast disiplinore.

3.Kremtimi i 7 Marsi-Dita e Mësuesit,137 vjetori i Mësojtores së Parë Shqipe(Korçë 1887).Komuna e jonë me Drejtorinë e Arsimit, për të tetëmbëdhjetën herë me radhë kanë ndarë çmimin tradicional“Mësimdhënës i dalluar“.Deri tani ky çmim u është ndarë 108 edukatorëve e mësimdhënësve.

Këshillat e Mësimdhënësve në Institucionet Arsimore për t`i përzgjedhur edukatorët e mësimdhënësit për çmimin mësimdhënës i dalluar janë mbështetur duke vlerësuar këto kritere: kualifikimin e mësimdhënësve; përvojën e punës,së paku 8 vjet në procesin edukativo-arsimor; punët dhe detyrat e realizuara, të cilat kanë reflektuar në procesin edukativo-arsimor; puna dhe rezultatet,që e veçojnë nga të tjerët; organizimi i mësimit shtues-plotësues me nxënësit që kanë ngecje në mësim; zhvillimi i rregullt i takimeve me prindër dhe këshillin e arsimtarëve; organizimin edhe mbajtjen e aktiviteteve jashtë kurrikulare;raportet dhe bashkëpunimet me kolegë, drejtuesit e institucionit dhe prindërit dhe trajnime profesionale të përfunduara,të cilat janë të akredituara dhe licensuara nga MASHTI.

Është shënuar 7 Marsi-Dita e Mësuesit, ku është ndarë edhe Çmimi tradicional “Mësimdhënës i dalluar” për : edukatoren **Hava Kutlovci** nga IP”Rrita jonë “ në Obiliq; mësimdhënësin e TIK-ut **Nusret Zeka**,nga SHFMU“Dr.Ibrahim Rugova”në Obiliq, i cili nga komisioni komunal i drejtorëve të shkollave është përzgjedhur nga komuna për të konkurruar për çmimin “Shaban Jashari “ në MASHTI , ku dhe ka fituar Çmimin “Shaban Jashari” në MASHTI;mësuesja **Myrvete Asllani** ,nga SHFMU “Hasan Prishtina “në Milloshevë;mësimdhënësjja e biologjisë **Leutrime Kupina** ,nga SHFMU“Pandeli Sotiri”në Obiliq;mësimdhënësjja e gjuhës angleze

Bukurije Totaj,nga SHFMU“Naim Frashëri“në Breznicë;mësimdhënësi i TIK-ut **Haki Imeri**, nga SHFMU“Fazli Graiçevci“ në Hade;mësimdhënësi i gjuhës angleze **Xhelal Krasniqi**,nga SHFMU “Migjeni” në Siboc;mësuesja **Emira Lumi Zeqiri**, nga SHFMU”Abdurrahmon Gërguri “ në Dardhishtë;mësimdhënësi i gjuhës angleze **Arsim Shaljani** nga Gjinnazi “17 Shkurti “ në Obiliq dhe mësimdhënësjja e matematikës , **Ermira Dubova Fejza** nga SHMLP“Ismail Dumoshi “ në Obiliq.

Drejtorja e Arsimit vazhdimisht ka vlerësuar dhe vlerësojnë punën e mësimdhënësve dhe punëtorëve teknikë .Andaj, me këtë rast ju ndahen mirënjohje mësimdhënësve të pensionuar dhe punëtorëve teknkë, të cilët janë pensionuar gjatë vitit 2023, të cilët kontribuan me përkushtim në procesin edukativo-arimor, të cilët janë znj. Magbule Aliti, edukatore nga SHFMU”Dr. Ibrahim Rugova” në Obiliq; znj.Selvete Thaçi , mësuese klase në SHFMU”Hasan Prishtina“në Milloshevë; z.Ahmet Murati, mësimdhënës i TIK-ut nga Gjinnazi “17 Shkurti “ Obiliq; z.Nexhmedin Durmishi, mësimdhënës i makinerisë nga SHMLP”Ismail Dumoshi “ në Obiliq z. Aziz Murati , shtëpiak nga IP “Rrita jonë “ në Obiliq z. Mexhid Pllana,punëtor teknik në SHFMU”Abdurrahmon Gërguri “ në Dardhishtë dhe z. Nazif Preniqi, punëtor teknik nga SHMLP”Ismail Dumoshi “ në Obiliq.

Drejtorja e Arsimit ndan mirënjohje duke falenderuar të gjithë ata,të cilët po ndihmojnë arsimin në Komunën e Obiliqit për zhvillim në të gjitha fushat, ngritje në cilësië, për kontributet për udhëheqje, menaxhim, bashkëpunim, koordinim, për fitim të projekteve kapitale dhe zbatim të standardeve të drejtorëve në procesin edukativo-arsimor.
Mirënjohje ndahen për: z.Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës së Obiliqit, i ndahet mirënjohje për kontributin për zhvillimin e arsimit dhe projektin e digjitalizimit për Institucionet Arsimore;z.Agim Preniqi, zyrtar zotues për kontributin që ka dhënë në Drjtorinë e Arsimit dhe bashkëpunimin me Institucionet Arsimore.znj.Ragbeta Gashi, drejtoreshë në SHFMU”Naim Frashëri” në Breznicë për menaxhim dhe zbatim të standardeve të drejtorëve në procesin edukativo-arsimor;z.Bedri Neziri, për menaxhim dhe zbatim të standardeve të drejtorëve në procesin edukativo-arsimor dhe z.Ismail Shalaku, drejtor në ShFMU ”Abdurrahmon Gërguri “ në Dardhishtë për menaxhim dhe zbatim të standardeve të drejtorëve në procesin edukativo-arsimor.

4.Projekti “Drejt Malit “2024 është realizuar në bashkëpunim me MASHTI dhe ShFMU “Migjeni “ në Siboc, ku nxënësit e klasës së shtatë janë përzgjedhur për qëndrim njëjavor në Brezovicë, sepse kanë pasur sukses më të mirë në nivel të shkollave në komunën e Obiliqit.

5.Projekti “Java e dyrve të hapura “ është realizuar nga DA , ku nxënësit e klasëve të nënta nga shtatë shkolla fillore të mesme të ulta kanë vizituar shkollat e mesme të larta në komunën tonë dhe janë njoftuar me drejtimet që kanë SHMLP”Ismail Dumoshi “ dhe Gjimnazi “17 Shkurti “ në Obiliq. Punëtoritë, kabinetet, mjetet e TI dhe mjetet didaktike.

6.Projekti me INFRAKOS-in për rregullat e infrakosit me nxënës që jetojnë afër vendbanime, ku përfshihet hekurudha në Komunën e Obiliqit.

7.Ekskursioni i maturantëve në bashkëpunim me ShMLP”Ismail Dumoshi “ në Obiliq.

Shpenzimet buxhetoore për gjashtë muaj në disa kategori

	Arsimi Parafill	Arsimi Parafillor	Drejtoria e Arsimit	Ars. Fillor.mes	Drejtoria e Arsimit	Arsimi fillor	Arsimi fillor	A.i mesëm	Arsimi i mesëm	Drejtoria e Arsimit	Donacion fillore
	Mallra dhe shërbime	Komunalit	Kapitalet	Kapitalet	Mallra dhe shërbime	M.shërbimet	Komunalit	Mallra dhe shërbime	Komunali	Subvencione	Qeveria Japoneze
Buxheti-10	5,830.00	2,000.00	90,000.00	100,000.00	14,170.00	205,830.00	17,000.00	41,733.00	13,000.00	140,000.00	67,122.00

Buxheti 21	9,000.00	1,000.00	90,000.00	100,000.00	80,000.00					50,000.00	
Buxheti-22	4,930.00					677.69	8,000.00				
											67,122.00
Zotime	3,872.55	1,274.70	178,000.00	0.00	0.00	135,627.59	7,851.28	0.00	6,125.24	167694.00	67,122.00
Mbetje	1,957.45	725.30	0.00	200,000.00	94,170.00	70,202.41	9,148.72	0.00	6,874.76	0.00	0.00

Suksesi i nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të parë, 2023/24 për klasët 1-5, 6-9 dhe 10,11 dhe 12

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Suksesi i nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të parë, 2023/24

Arsimi fillor (1-5)

Komuna Obiliq

Klasa	Nr.	Nr. nxënësve	Suksesi pozitiv										Gjithsej me nota të pamjaftue				Numri i mungesave		
			Shkëlqyeshëm		Sh. mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Gjithsej me nota pozitive		Të pa notuar		Të arsyes	Të paarsy	Gjithsej		
			Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%			
1	19	282	204	72.34	37	13.12	20	7.09	15	5.32	276	97.87	5	1.773	1	0.4	3331	1172	4503
2	19	323	199	61.61	62	19.20	38	11.76	14	4.33	313	96.90	10	3.096	0	0	3414	1620	5034
3	19	299	156	52.17	75	25.08	39	13.04	15	5.02	285	95.32	13	4.348	1	0.3	3473	1440	4913
4	19	290	143	49.31	71	24.48	45	15.52	22	7.59	281	96.90	9	3.103	0	0	3875	1185	5060
5	18	311	146	46.95	84	27.01	61	19.61	11	3.54	302	97.11	9	2.894	0	0	4044	379	4423
GJ	94	1505	848	56.35	329	21.86	203	13.49	77	5.12	1457	96.81	46	3.056	2	0.1	18137	5796	23933

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Suksesi i nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të parë, 2023/24

Arsimi i mesëm i ulët (6-9)

Komuna Obiliq

Klasa	Nr. paraleleve	Nr. nxënësve	Suksesi pozitiv										Suksesi i pamjaftueshëm								Numri i mungesave				
			Shkëlqyeshëm		Sh. mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Gjithsej me nota pozitive		Me 1 notë të pamjaftueshme		Me 2 nota të pamjaftueshme		Me 3 e më shumë nota të pamjaftueshme		Gjithsej me nota të pamjaftueshme		Të pa notuar		Të arsyeshme	Të paarsyeshme	Gjithsej
			Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%			
6	18	353	101	29	85	24.08	66	19	5	1.42	257	72.8	53	15	16	5	26	7.37	95	27	1	0.28	7776	2693	10469
7	19	308	63	20	73	23.7	78	25	11	3.57	225	73.05	39	13	11	4	31	10.06	81	26	2	0.65	6277	1861	8138
8	19	305	63	21	61	20	70	23	17	5.57	211	69.18	33	11	17	6	44	14.43	94	31	0	0.00	8394	1363	9757
9	19	318	86	27	62	19.5	60	19	7	2.2	215	67.61	44	14	16	5	43	13.52	103	32	0	0.00	7610	2979	10589
GJ	75	1284	313	24	281	21.88	274	21	40	3.12	908	70.72	169	13	60	5	144	11.21	373	29	3	0.23	30057	8896	38953

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIREQENIES SOCIALE

Drejtoria e shëndetësisë dhe mireqenies sociale në kuadër të përgjegjësisë të veta ka kryer punë dhe detyra të shumta.

Fillimi i punimeve në:”Mbindërtimi-Renovimi i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare ”në Obiliq.

Memorandum bashkëpunimi në mes të komunës së Obiliqit dhe Sos Fshatrat e Fëmijëve të Kosovës.

AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Këshilli drejtues i QKMF-së ka vazhduar me takimet ditore rreth rrjedhës së punës, marrjen e të gjitha masave për ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore ,mbajtjes së disiplinës ,orarit të punës.

Shërbime shëndetësore cilësore 24/7.

Vizita të vazhdueshme monitoruese të gjitha njësive të QKMF-së.

Vizita në shtëpi për nënat shtatzëna dhe fëmijët deri në moshën tre vjeçare.

Furnizim me material shpenzues mjekësor.

Furnizim me material për shërbime laboratorike.

Furnizim me pajisje stomatologjike.

Furnizim me material higjienik.

Furnizim me material administrativ, administrativo-shëndetësor.

Pranimi i testeve antigjene në QKMF.

Asgjësimit i barnave dhe mbetjeve mjekësore në QKMF.

Takime të vazhdueshme me menaxhmentin e QKMF-së.

Vaksinimi i rregullt për fëmijët e grup moshave të caktuara sipas kalendarit të vaksinimit si dhe vaksinimi i nxënësve.

Vaksinimi i nxënësve të klasëve të gjashta me vaksinën kundër kancerit të qafës së mitrës (HPV).

Fluorizimi i dhëmbëve të përhershëm të nxënësit e klasëve të gjashta të komunës së Obiliqit.

Kontrollat sistematike për nxënësit e klasëve të para, të pesta dhe të nënta të komunës së Obiliqit, ku të gjitha të dhënat e vizitave sistematike u evidentuan në kartelat shëndetësore të qdo nxënësi.

Identifikimi i nevojave për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore në kuadër të KPSH-së.

Identifikimi i nevojave për lehtësimin e punës së përditshme të personelit.

Përgatitje e specifikave për procedura prokurimi.

Përmirësimi i infrastrukturës së institucioneve të KPSH, Inventarizimi.

Ekipe mjekësore të QKMF-së kanë asistuar dhe mbështetur aktivitetet kulturo-sportive.

Takime të përditshme me qytetarë.

Janë kryer punët e përditshme tekniko - administrative (fatura, kërkesa, etj.)

Vizita për personat në gjendje të rëndë shëndetësore ,ata të cilët për shkak të gjendjes nuk mund të shkojnë te mjeku, ku i ofrohen të gjitha shërbimet (dhënia e terapisë, marrja e gjakut etj).

Hapja e laboratorit biokimik në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Milloshevë.

Aprovimi i draft Statutit-“Forma Unike e Statutit të QKMF-Obiliq”.

Kërkesat për nevoja shëndetësore dhe sociale

Janar – Qershor 2024:

Të aprovuara	565
--------------	-----

Kërkesat për nënat lehona

Janar – Qershor 2024

Të aprovuara	156
--------------	-----

Drejtoria e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale,duke u bazuar në kërkesat dhe nevojat e QKMF-së dhe QPS-së, përmes zyrës së prokurimit,ka iniciuar këto procedura:

Titulli i projektit	Vlera
Dezinfektim, Deratizim, Dezinsektim në institucionet publike (DDD)	30,000.00 €
Asgjësim i barnave me afat të skaduar dhe mbetjeve mjekësore	4,650.00 €
Furnizim me material administrativ për QKMF	3,000.00 €
Furnizim me material higjenik	9,998.05 €
Furnizim me paisje stomatologjike për QKMF-Obiliq	2,500.00 €

RAPORTI I SHPENZIMEVE

MALLRA DHE SHËRBIME	ZOTIM
Karburante për vetura	6,295.46 €
Vendime gjyqësore	4,470.43 €
Internet	80.94 €
Mirëmbajtja e dozimetrave	120.00 €
Furnizim me material administrativ	1,288.00 €
Furnizim me material mjekësor	30,000.00 €
Asgjësimit i barnave me afat të skaduar dhe mbetjeve mjekësore	2,142.00 €
Dezinfektim, Deratizim, Dezinsektim në institucionet komunale (DDD)	1,000.00 €
Regjistrimi i automjeteve	105.00 €
Mirëmbajtja e hapësirave publike	3,690.01 €
Meditje	128.45 €
Shërbime me aparat fotokopjues	100.31 €
Avans për para të imta	500.00 €
Furnizim me mjete higjienike	5,201.75 €
Furnizim me Oksigjen	105.60 €
Blerja e paisjeve stomatologjike	1,000.00 €
Mirëmbajtja e veturave	4,000.00 €

SHPENZIMET KOMUNALE

SHPENZIM

Rrymë elektrike	8,832.17 €
Ujë	1,708.99 €
Telefon	379.73 €

QKMF

Gjatë kësaj kohe këshilli drejtues i QKMF-së ka vazhduar me takimet ditore rreth rrjedhës së punës, marrjen e të gjitha masave për ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, disiplinës, orarit të punës etj.

Në QKMF janë trajtuar një numër i madh i pacientëve dhe janë ofruar një numër i konsiderueshëm i shërbimeve (shih tabelën)

NUMRI I PACIENTËVE DHE NUMRI I SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE

Nr.	QENDRA KRYESORE E MJEKËSIS FAMILJARE	Numri i pacientëve	Numri i shërbimeve mjekësore
1.	QKMF Obiliq	47877	109425
2.	QMF Milloshevë	2675	8374
3.	QMF Plemetin	911	3670
4.	AMF Siboc	1130	3463
5.	AMF Breznicë	1014	2079
6.	AMF Babimoc	1373	4831
	TOTALI:	54980	131842

REFERIMET

QKMF -OBILIQ	Nr. i ref. <u>KONSU</u> <u>LTIME</u> në kujdesin tretësor	Nr. i ref. <u>DIAGN</u> <u>OS..</u> kujd tretësor	Nr i ref. QENDRA EMERGJE NTE	Udhëzi me për Kujde. tretësor	Nr. i përgjiths hëm i vizitave mjekës..	Përqindja (%) e të referuarve në kujdesin tretësor
---------------------	--	--	--	--	---	--

	Njësia	Departamenti						
1	QKMF Obiliq	Mjekësi Familjare	3341	820	334	4495	23446	19.1 %
2	QKMF Obiliq	Emergjencia	201	0	1264	1465	10139	14.4 %
3	QKMF Obiliq	Pediatria	148	37	4	189	2573	7.3 %
4	QKMF Obiliq	Gjinekologjia	92	78	0	170	1165	14.5 %
5	QKMF Obiliq	Kujdesi Paliativ	2	6	6	14	1868	0.7 %
6	QKMF Obiliq	Shëndeti oral	32	71	0	103	2129	4.8 %
7	QMF Milloshevë	Mjekësi Familjare	347	33	19	399	2405	16.5 %

8	QMF Milloshe vë	Shëndeti Oral	0	12	0	12	73	16.4 %
9	AMF Plemetin	Mjekësi familjare	14	0	1	15	911	1.6 %
10	AMF Breznicë	Mjekësi Familjare	137	10	1	148	1130	13 %
11	AMF Siboc	Mjekësi Familjare	128	23	4	155	1014	15.2 %
12	AMF Babimoc	Mjekësi familjare	287	42	0	329	1373	23.9 %
			4729	1132	1633	7494	48226	15.5 %

Të dhënat për sëmundjet masive jo infektive

- 1.F00,F04,F05 ,F09,F20,F30,F31,F32.3,F33,F22,F29,F84,G71(shëndetit mental)
- 2.E10-E14,(sëmundjes së sheqerit)
- 3.I00-.I02,I20,I21,I24,I25(sëmundjeve kardiovaskulare)
- 4.N05(nefropatit)N03,N04,N05,N10,N18
- 5.J42,J45,J47 ,(sistemit respirator)
- 6.D65-D69,C-(sëmundje malinje),

Sëmundjet	Numri
I10	333
I20, I21, I24, I25	2
E10-E14	186
J42, J45, J47	45
N03, N04, N05, N10, N18	7
F00-F48	15
Sëmundjet malinje	22
Numri i referimeve në nivelin sekondar	4729
Numri i referimeve në diagnostikë	1132
Gjithsej pacientë	48226

Janar-Qershor janë dorëzuar gjithësej këto fletëparaqitje

Sëmundje masovike jo ngjitëse	651
Sëmundje malinje	23

Raportimet ditore

Sëmundjet e traktit Respirator	8818
--------------------------------	------

Sëmundjet ngjitës të raportuara

Sëmundjet	Numri
Pneumonia	156
Diare	780

Variqellë	77
Dyshim në grip	1199
Dyshim në fruth	1
Dyshim në tularemi	1

QKMF-OBILIQ 01.01.2024-30.06.2024

Raport i numrit të pacientëve sipas shërbimit nga Web Aplikacioni – QKMF

Njësia: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare	
Gjinekologjia	475
Kujdesi Paliativ	177
Laboratori	410
Mjekësia Familjare	3144
Pediatria	584
Rëntgen	0
Shëndeti Oral	320
Shërbimi Emergjent	1074

SHËRBIMET SHËNDETËSORE TË OFRUARA NË QKMF

DEPARTAMENTI I MJEKËSISË FAMILJARE

Nr.	Spektori i mjekësisë familjare	Nr. i shërbimeve
1.	Numri i pacientëve të vizituar	21376
	Gjithsej shërbime	32344

Nr.	Këshillimorja për personat me diabet dhe hipertension	Nr. i shërbimeve
1.	Nr. i pacientëve	717
	Gjithsej shërbime	1820

Nr.	Vizitat shtëpiake për nënën dhe fëmijët deri në 3 (tre) vjet (Takime virtuale)	Nr. i shërbimeve
1.	Nr. i vizitave në shtëpi	197
2.	Nr. i fëmijëve të përfshirë në vizitë	181
3.	Nr. i shtatzënave të përfshirë në vizitë	16
4.	Nr. i rasteve të Komunitetit Rom Ashkalinj të përfshirë në vizitë	49
5.	Puna në grupe “Klasat për Nëna”	242

SEKTORI I KUJDESIT EMERGJENT

Nr.	Kujdesi Emergjent	Nr. i shërbimeve
1.	Numri i pacientëve të vizituar	10139
	Gjithsej shërbime	17695

KUJDESI PALIATIV

Nr.	Kujdesi Emergjent	Nr. i shërbimeve
1.	Numri i pacientëve të vizituar	1868
	Gjithsej shërbime	5306

SEKTORI I SHËNDETIT PUBLIK

Nr.	Njësia e SISH	Nr. i shërbimeve
1.	Numri i pacientëve të regjistruar	7390

Nr.	Njësia e Vaksinimit dhe Imunizimit	Nr. i shërbimeve
1.	Numri i pacienteve ne qender dhe teren	3047
	Gjithsej shërbime	5349

Nr.	Njësia e Vaksinimit dhe Imunizimit	Nr. i shërbimeve
1.	Dhënia e vaksinave	1326
2.	Shërbime tjera	974

SEKTORI I SHËNDETIT ORAL

Nr.	Shëndeti Oral	Nr. i shërbimeve
1.	Numri i pacientëve	2129
	Gjithsej shërbime	6587

SEKTORI KONSULTATIV

Nr.	Njësia e Pediatriisë	Nr. i shërbimeve
1.	Numri i pacientëve të vizituar	2573
	Gjithsej shërbime	4783

Nr.	Njësia e Gjinekologjisë	Nr. i shërbimeve
------------	--------------------------------	-------------------------

1.	Numri i pacientëve të vizituar	1165
	Gjithsej shërbime	3350

SEKTORI I DIAGNOSTIKËS

Nr.	Laboratori	Nr. i shërbimeve
1.	Numri i pacientëve	1974
	Totali i parametrave të punuara	21358

	RTG	Nr. i shërbimeve
1.	Nr. i pacientëve	1191
	Gjithsej shërbime	4828

Nr.	Ultrasonografi	Nr. i shërbimeve
1	Nr. i pacientëve	141
	Gjithsej shërbime	434

Nr.	Barnatorja në QKMF,QMF,AMF	Nr. i shërbimeve
	Gjithsej pacientë	2975
	Gjithsej receta	5434

MJEKËSIA FAMILJARE NË TEREN

Nr.	QMF Milloshevë	Nr. i shërbimeve
1.	Numri i pacientëve të vizituar	2405

	Gjithsej shërbime	5244
--	-------------------	------

Nr.	AMF Plemetin	Nr. i shërbimeve
1.	Numri i pacientëve të vizituar	911
	Gjithsej shërbime	3662

Nr.	AMF Siboc	Nr. i shërbimeve
1.	Numri i pacientëve të vizituar	1130
	Gjithsej shërbime	3463

Nr.	AMF Breznicë	Nr. i shërbimeve
1.	Numri i pacientëve të vizituar	1014
	Gjithsej shërbime	2079

Nr.	AMF Babimoc	Nr. i shërbimeve
1.	Numri i pacientëve të vizituar	1373
	Gjithsej shërbime	4465

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS

Departamenti i administratës këtë vit ka funksionuar pa ngecje. Në vazhdimësi është raportuar në baza ditore, javore, mujore, është mbajtur evidenca rreth vijueshmërisë të punëtorëve. Organizimi i pushimeve vjetore, përpilimi i listave të kujdestarive në vazhdimësi janë përpiluar nga Kryeshefi i Dep. të MF, Shefi i Administratës në bashkëveprim me Kryeinfermierën.

TË HYRAT NGA PARTICIPIMI

Data e dorëzimit (Janar-Qershor)	Shuma	Vendi ku janë dorëzuar
Gjithsej	12,640.00 €	NLB

RAPORT I KARBURANTEVE

Periudha	Benzinë	Diesel
Janar –Qershor		5960 litra

NJËSIA PËR SHËRBIME TEKNIKE

Sa i përket furnizimit me material higjienik ka qenë i kënaqshëm. Higjiena ka qenë në nivel të duhur-me vërejtje të kohëpaskohshme.

BARNATORJA QËNDRORE

Furnizimi me barëra brenda periudhës janar-qershor ka qenë i kënaqshëm. Kemi mungesë të madhe me barna nga lista esenciale e barnave. Barërat që kanë arritur në barnatore janë shpërndarë vazhdimisht nëpër QMF dhe AMF. Kërkesat për barëra nga lista esenciale janë dorëzuar në korporatë me rregull. Po ashtu vlen të përmendet se furnizimi me insulinë ka qenë në nivel të kënaqshëm.

ZHVILLIMI I VAZHDUESHËM PROFESIONAL (ZHVP)

Në QKMF në kuadër të ZHVP-së u mbajtën dymbëdhjetë(12) ligjërata për mjek dhe infermier ,ligjërata këto të aprovuara nga OMK dhe OIK.

Jashtë qendrës u mbajtën gjashtëmbëdhjetë (16) trajnime për mjek dhe njëmbëdhjetë (11) trajnime për infermier.

Edukimi dhe promovimi shëndetësor

AKTIVITETET

Sipas rekomandimeve të IKSHPK-së dhe MSH, me datë 20.02.2024 në nivel vendi ka filluar veksnimi i rregullt, për nxënësit e klasave të VI-ta, si dhe për herë të parë në Kosovë në këtë vit vajzat në klasën e VI-të , do të vaksinohen edhe me vaksinën kundër kancerit të qafës së mitrës (HPV) ,krahas hyrjes në përdorim të tri (3) vaksinave të reja në kuadër të kalendarit të rregullt të vaksinimit.

Në kuadër të ditës ndërkombëtare të Hipertensionit arterial , në sheshin “Dëshmorët e Kombit”, ekipi i QKMF-së,ku ofruan shpjegime rreth hipertensionit, shkaktarët dhe pasojat ,si dhe hapat që duhet ndërmarrë në parandalimin e shtypjes së lartë të gjakut, ku u bë edhe shpërndarja e 100 fletushkave.

Në bashkëpunim me drejtorinë komunale të arsimit, dhe Qendrën Rinore, në kuadër të ditës së fëmijëve , është zhvilluar një aktivitet me fëmijët e komunës së Obiliqit, aktivitet rreth edukimit shëndetësor.

Në bashkëpunim me drejtorinë komunale të arsimit dhe AMC ,është mbajtur ligjeratë me nxënësit e klasëve të pesta , me temën “Vaksina kundër kancerit të qafës së mitrës”.

Në bashkëpunim me IKSHPK, UNICEF, BALLKAN SUN FLOWERS ,në kuadër të javës së vaksinimit dhe imunizimit,janë mbajtur ligjerata në komunitetin rom,ashkali dhe egjiptas, gjithashtu është bërë vaksinimi i fëmijëve të këtijë komuniteti.

QENDRA PËR PUNË SOCIALE

OFRIMI I NDIHMËS SOCIALE

Sipas kushteve dhe kriterëve që parashihen me aktet ligjore dhe nënligjore të Skemës së Ndihmave Sociale për periudhën raportuese , numri i familjeve është:

Numri i familjeve dhe anëtarëve të familjes së SNS-së në periudhën Qershor 2024.

Janar –

Muaji	Nr. i familjeve në SNS	Anëtarët e familjes në SNS	Shuma në €
Janar	529	2,256	70,700.00 €
Shkurt	534	2,243	71,370.00 €
Mars	527	2,219	70,160.00 €
Prill	526	2,227	70,700.00 €
Maj	527	2,215	70,100.00 €
Qershor	524	2,207	70,010.00 €
Total			523,040.00 €

Vërtetime të SNS-së : 72.

Janar- Qershor 2024 kemi këto:

Aplikime, Riaplikime, Riaktivizime dhe Ndërprerje.

Muaji	Aplikime	Ri aplikime	Riaktivizime	Ndërprerje
Janar	1	66	3	14
Shkurt	6	58	6	18
Mars	3	82	1	9
Prill	2	68	4	4
Maj	2	67	2	6
Qershor	1	52	2	11

Lëndët e komisionit mjekësor për periudhën Janar-Qershor 2024.

Muaji	Lëndët e aprovuara nga komisioni mjekësor	Lëndët e refuzuara nga komisioni mjekësor	Total
Janar	25	5	30
Shkurt	28	8	36
Mars	24	7	31
Prill	30	6	36
Maj	16	4	20
Qershor	18	6	24

Një donator ka ndihmuar tetë familje raste të rënda sociale me gjëra ushqimore në vlerë

100 € (për familje). në muajin e shenjtë të ramazanit.

Janë shpërndarë 400 pako ushqimore për familjet, raste të rënda sociale, me gjëra ushqimore, donator Organizata Qatar Charity, përfshirë edhe komunitetet.

Janë shpërndarë 75 pako ushqimore për familjet (nënat vetëushqyese) ,raste të rënda sociale ,me gjëra ushqimore, donator The Embassy of UAE in Podgorica.

Janë shpërndarë 300 pako ushqimore (mish kurban) për komunitetin rom,ashkali dhe egjiptas, donator Organizata Qatar Charity,

Janë shpërndarë 200 pako ushqimore , për familjet, raste të rënda sociale,donator shoqata Bereqeti, në bashkëpunim me këshillin e bashkësisë islame në Obiliq.

RAPORT I SHËRBIMEVE SOCIALE DHE FAMILJARE

Gjatë periudhës Janar-Qershor 2024 në shërbimet sociale dhe familjare janë paraqitur gjithsej **438** raste:

1. Fëmijë pa kujdes prindëror - **18**
2. Strehim familjar tek të afërmit – **13**
3. Kërkesa për adoptim vendor - **1**
4. Kërkesa për adoptim ndërkombëtar -**1**

5. Fëmijë i keqtrajtuar - **7**
6. Fëmijë me sjellje asociale - **2**
7. Përdoruesit e substancave narkotike- **Nuk ka të dhëna**
8. Puna e rrezikshme -**16**
9. Rrëmbim ndërkombëtar I fëmijëve -**0**
10. Të miturit në konflikt me ligjin - **29**
11. Viktimat e dhunës në familje -**47**
12. Viktimat e trafikimit- **16** (Viktimë e trafikimit po konsiderohen edhe rastet që detyrohen për lypsari)
13. Viktima e krimeve seksuale - **3**
14. Martesa e të miturve - **4**
15. Këshilla martesore (Divorc) - **42**
16. Të moshuarit - **1**
17. Klient të tjerë:
 - a. Me probleme familjare -**47**
 - b. Nënat vetushqyese -**9**
 - c. Personat me aftësi të kufizuar - **0**
 - d. Fëmijë me aftësi të kufizuar -**61**
 - e. Aftësia e prindërve nuk është adekuate për përkujdesje ndaj fëmijës – **6**
 - f. Vërtetim për armëmbajtje –**22**
 - g. Vërtetim për punësim - **65**
 - h. Vërtetim për SNS – **8**
 - i. Vërtetim për humbje të shtetësisë - **5**
 - j. Nëna e cila potencialisht do të braktisë fëmijën e saj - **5**
 - k. Nëna e cila e ka braktisur fëmijën e saj - **2**
 - l. Babai i cili ka braktis fëmijën e tij - **1**
 - m. Regjistrimi i më vonshëm i fëmijëve - **2**
 - n. Arsye tjetër – **21**

Lidhur me ofrimin e Shërbimeve sociale janë ofruar **510** aktivitete të ndryshme të kategorive sociale si: vizita në shtëpi, intervista, intervenime dhe bashkëpunim ndërinstitucional.

Me organizata kemi mbajtur takime si: OFAP-in, UNICEF-i, KOMF, SOS - Fshati, bashkëpunim me MPMS-në, Komunën, Shtëpinë Strehuese në Prishtinë, Policinë e Kosovës, Gjykatat etj.

Me organizatën OFAP kemi të kontraktuar një herë në javë psikologun për raste të veçanta.

DREJTORIA E INSPEKSIONIT

1.	Inspektime të përgjithshme (vërejtje, qortim,etj) verbal	
2.	Inspektime të përgjithshme - procesverbal për kontrollin inspektues	158
3.	Inspektim me procesverbal për kontrollin inspektues në Komunikacion	4
5.	Inspektim me procesverbal për kontrollin inspektues në Ndërtim	57
6.	Inspektim me procesverbal për kontrollin inspektues në Treg	97
7.	Aktvendim për ndalim të punimeve	3
8.	Aktvendim për rrënim	3
9.	Urdhër ekzekutimi për rrënim	6
10.	Aktvendim për shfuqizim-urdhër ekzekutimi për rrënim	
11.	Aktvendim për gjobë mandatore	5
12.	Urdhëresë për pages për ndeshkim	5
13.	Vendim për refuzim të ankesave	2
14.	Kërkes për Gjykatë	
15.	Kërkes për kallxim penal	
16.	Kërkes për permbarim	4
17.	Kërkes për MMPHI	1
18.	Asgjasim të produkteve -ATK	
19.	Kërkesë për AVU- Inspektorin e Veterinës	
20.	Raport final për Qertifikat të përdorimit për objekt	4
21.	Pranim me komision për kushte higjeno sanitare -Pëlqim	25
22.	Refuzim i kërkesës Pëlqimit me komision për kushte higjeno sanitare	
23.	Përgjigje në kërkes	
24.	Kërkesë për asistencë P.K-S.Policor Obiliq.	2

25.	Kërkesa për DSHPE	2
26.	Miratuar	94
27.	Pranuar	1
28.	Refuzuar	8
29.	Hedhur poshtë	1
30.	Në proces	12
31.	Totali	118

DREJTORIA PËR SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCË

Drejtorja e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës promovon dhe zbaton politikat e përgjithshme të shërbimeve publike dhe kryen koordinimin e aktiviteteve të tjera ditore, javore dhe mujore.

Aktivitetet për vitin 2024

- Menaxhimi i situatave emergjente.
- Mirëmbajtja e rrugëve dhe pastrimi i tyre gjatë dimrit.
- Përgatitja e stafit dhe dokumenteve bazë për fatkeqësi natyrore dhe rreziqe tjera.
- Mirëmbajtja dhe deblokimi i kanalizimeve.
- Mirëmbajtja e ndriçimit Publik.
- Sinjalizimi horizontal dhe vertikal.
- Shërbimin e recepsionit të objektit të Kuvendit Komunal.
- Ndërtimi i hapësirave për komunitet
- Digjitalizimi i rrugëve dhe objekteve publike në Komunën e Obiliqit
- Transporti publik lokal.
-

Aktivitet tjera të DSHPE-së

Gjatë Muajit Janar – Qershor 2024 kemi trajtuar 529 kërkesa të ndryshme nga qytetaret, operatorët ekonomik, KEDS, KRU Prishtina, ku nga to janë shqyrtuar 527, të miratuar 440, të refuzuara 64, në proces 22. Janë lëshuar 9 Pëlqime- të natyrave të ndryshme. Kemi trajtuar raste të intervenimit në deblokim të rrjetit të kanalizimit nëpër qytet dhe fshatra të territorit të komunës sonë. (në bashkëpunim me kompaninë publike KRU-Prishtina njësia në Obiliq.

Pastrimi i deponive të mbeturinave në tërë territorin e komunës.

Kontratat që janë menaxhuar dhe vazhdojnë të menaxhohen nga DSHPE nga vitet paraprake e deri më 30.06.2024 dhe vazhdojnë ende:

1. **Kontrata:** *“Fshirja, larja dhe mbledhja e mbeturinave në rrugët, trotualet dhe shiritat e gjelbërt si dhe në sheshet e komunës së Obiliqit si dhe zbrazja e mbeturinave nga shportat përgjatë rrugëve”*
2. **Kontrata:** *“Kontrate për shërbime (Kontrata në Shtëpi”) Ofrimi i Shërbimeve të recepsionit në objektet komunale*
3. **Kontrata:** *“Kontratë për shërbime (Kontrata në Shtëpi”) Mirëmbajtja e hapësirave publike në territorin e komunës së Obiliqit”*
4. **Kontrata:** *“Kontratë për shërbime (Kontrata në Shtëpi”) Mirëmbajtja e Ndriçimit Publik në tërë territorin e komunës së Obiliqit”*
5. **Kontrata:** *“Sigurimi i veturave zyrtare”*
6. **Kontrata:** *“Servisimi i veturave zyrtare”*
7. **Kontrata:** *“Mirëmbajtja e veturave”*
8. **Kontrata:** *Shtruarja e rrugëve me zhavor*
9. **Kontrata:** *“Shërbimet e Autolarjes së veturave dhe Vullkanizimit”*
10. **Kontrata:** *“Furnizim me karburante (Benzin-Dizell)*
11. **Kontrata:** *Pastrimi i mbeturinave ilegale, rrënimi i objekteve, pastrimi i shtratit të përroskave-lumenjëve e shërbime tjera publike dhe për raste emergjente*

DSHPE ka iniciuar procedura për lidhjen e kontratave për:

Sinjalizimi horizontal dhe vertikal, Blerja e kontenjerve.

Më poshtë paraqesim në mënyrë tabelare rastet e zjarrit e të cilat janë evidentuar nga ana e drejtorisë.

1. Zjarret sipas pronësisë:

- Pronësi shoqërore -----3
- Pronësi private -----3

Shpenzimet e derivateve gjatë gjashtë (6) mujorit të parë të vitit 2024

Shpenzimet e naftës së veturave për 6 mujorin e parë të vitit 2024			
Nr	Muaji	Litra	Vlera në euro
1	Janar-Qershor	4702.96	5844.25

Shpenzimet e benzinës së veturave për 6 mujorin e parë të vitit 2024			
Nr	Muaji	Litra	Vlera në euro
1	Janar-Qershor	2302.19	2810.33

Shpenzimet e naftës së Minibusave për 6 mujorin e parë të vitit 2024			
Nr	Muaji	Litra	Vlera në euro
1	Janar-Qershor	3312.31	4130.92

Shpenzimet e energjisë elektrike Janar - Mars 2024

Shpenzimet e energjisë elektrike per periudhën Janar-Maj 2024								
Nr	Muaji	Komuna	Aneksi i objektit komunal	Biblioteka	Palestra e sportit	Shtëpia e kulturës	Qendrat rinore	Ndriçimi
1	Janar-Maj	6,233.09	2.084.89	2,386.91	817.75	844.80	687.77	50,156.26
Gjithsejtë			63,211.47 €					

Shpenzimet e ujit Janar – Qershor 2024

Shpenzimet e ujit për periudhën Janar-Qershor 2024					
NR	Muaji	Komuna	Palestra e sportit	Zyre komunale	Biblioteka
1	Janar-Qershor	219.46	704.17	288.58	50.12
Total					1,262.33

DREJTORIA PËR MBROJTJE TË MJEDISIT

Aktivitetet të cilat zhvillohen në kuadër të kompetencave të drejtorisë:

1. **Monitorimi i gjendjes mjedisore;** ajrit, ujit, tokës dhe zhurmës përmes raporteve mujore nga TC-A, TC-B, Divizionit të Qymyrit, raportit të Institutit Hidrometeorologjik (IHMK) dhe monitori i vendosur në qendër të Obiliqit (sheshi Aziz Zhilivoda).

2. **Aktivitetet ditore që janë të përfshirë në Kompaninë Komunale NPL “Kastriot” Sh.A.**
“Mirëmbajtja e parqeve, shesheve, hapësirave gjelbëruese punohet në baza ditore, ndërsa punët tjera sipas kërkesave në teren.

- **Inspektimet ditore – respektimin e ligjit dhe udhëzimeve për mbeturinat, transporti i tyre e të ngjashme, inspektimet në biznese dhe ndotja e Mjedisit**

Në kuadër të kompetencave të Ligjit dhe planit për kontroll dhe mbikëqyrje, Drejtoria për Mbrojtjen e Mjedisit përmes inspektoreve komunal mjedisor ka realizuar inspektime (kontrolle) të vazhdueshme për të gjitha fushat e për ata që kanë vepruar në kundërshtim me udhëzimet dhe Ligjet Mjedisore, në vendin e ngjarjes u bënë procesverbale, vërejtje dhe rekomandime në përputhje me Ligjin për mbeturina dhe u shqiptuan edhe gjoba.

- **Shënimet e ditëve mjedisore** – në bashkëpunim me DSHPE, NPL”Kastrioti” Sh.A dhe KRM “Pastrimi”, janë shënuar aktivitetet e ditës së tokës, aksioni “Ta pastrojmë Kosovën”, etj.

- DMM gjatë kësaj periudhe, ka hartuar kontratën me NPL “Kastrioti” Sh.A si koordinatore e drejtorive përkatëse, ndërsa është në proces të hartimit Plani i Veprimit në Mjedis (Draft Plani).

- Gjatë këtij viti janë mbajtur trajnime në bashkëpunim me UNDP, GIZ dhe MMPHI në fushën e mjedisit dhe shkëmbim të përvojave, gjithashtu takime dhe trajnime në fushën e Energjisë së Ripërtitshme.

3. **Hartimi i Projekteve për këtë vit:** për vitin 2024 janë punuar (hartuar) projekte drejtuar KEK-ut;

- Mbjellja e drujve (në Mazgit),
- Parku në Breznicë,
- Projekti i ekoulseve me sistem gjelbërimit,
- Pastrimi i prockës Obiliq i vjetër.

- Në kuadër të kompetencave që ka DMM ka reaguar (vepruar) në lidhje me KEK, gjithnjë duke u bazuar në raport të Institutit Hidrometeorologjik (IHMK) dhe monitori i vendosur në qendër të Obiliqit (sheshi “Aziz Zhilivoda”).

- **Inspektime Deponisë Sanitare Mirash dhe autotransportusve që bartin mbeturina**

Në kuadër të mbikëqyrjes të aktiviteteve, përputhshmërinë e aktiviteteve me standardet dhe normat ligjore për mbrojtje të mjedisit, është bërë kontrolli i vazhdueshëm në Deponinë Rajonale Mirash.

Në kuadër të kompetencave të Ligjit për mbeturina dhe planit për kontroll dhe mbikëqyrje, Drejtoria për Mbrojtjen e Mjedisit, përmes zyrtarëve komunal dhe inspektoreve mjedisor ka realizuar kontrole të vazhdueshme kamionëve për bartjen e mbeturinave komunale në Deponinë regjionale sanitare në Mirash. Gjatë kësaj periudhe u ndaluan të gjitha automjetet transportuese që bartnin mbeturina komunale. Në vendin e ngjarjes u dhanë, vërejtje dhe rekomandime në përputhje me Ligjin për mbeturina.

Raporti dhe plani i veprimit:

DMM për vitin 2024 ka hartuar planin e punës;

- DMM ka hartuar planin për kontroll dhe inspektim për të gjithë operatorët që veprojnë në Obiliq.

Gjatë kësaj periudhe kohore, nga zyrtaret mjedisor kanë kryer inspektime në shumë fusha që lidhen me çështjet mjedisore si në vijim:

Inspektimi të operatorët ekonomik, në hedhjen e mbeturinave, materialeve të ndryshme (inerte), përgjatë rrugëve, lumenjve, ndezje e zjarreve, si dhe ndotësit e tjerë në fushën e mjedisit.

- DMM- gjatë kësaj periudhe ka kryer edhe këto aktivitetet:

- Pranuar 55 kërkesa të llojeve të ndryshme,
- 21 kontrole të ndryshme rutinore - të planifikuar, (sipas planit vjetor),
- 19 vërejtje verbale,
- 33 inspektime – sipas kërkesave të qytetarëve (lloji inspektimit ankesa në mbeturina, djegie, shpërndarje të dheut etj),
- Janë shqyrtuar 55 kërkesa,
- Leje mjedisore (1 leje),
- Pëlqime dhe përgjigje në kërkesa të qytetarëve të llojeve të ndryshme.

Gjithashtu zyrtarët e DMM-së kanë qenë të angazhuar edhe me projekte të drejtorive tjera.

Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në Drejtori nga 01.01.2022 deri 31.06.2022

Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural duke u mbështetur në kompetencat të cilat derivojnë nga ligji për vetëqeverisje lokale, e ngarkuar me punët nga statuti i Komunës ka realizuar detyrat e hartuara për vitin 2020.

Duke i dhënë prioritet zhvillimit të bujqësisë, mbështetja ka filluar me përkrahjen e sektorit të blegtorisë, ekonomive të vogla familjare bujqësore, dhe rritjen e interesimit të qytetarëve për qasje me konstruktive në këtë lëmi.

AKTIVITETET E PUNËS

Bujqësia është një sektor i rëndësishëm potencial për zhvillimin ekonomik, për këtë arsye kemi vazhduar me projektet si:

1. “Ngritja e serave tunel 50 m² për perim-kulturë”.
2. ” Vaksinimi e kafshëve kundër sëmundjeve kolstridieve dhe fasciolave ,inseminimi artificiali gjedheve ,trajtimin e endometritit dhe atestuesit të gjedheve.
- 3.Trajtimi i Qenve Endacak
- 4.Ndertimi Minifermave për 5 krerë lopë qumështore
- 5.Subvencionimi për ujitjen e tokave në sistemin e ujitjes “Iber-Lepenëc

Drejtoria në këtë periudhë ka bërë vazhdimisht monitorimin dhe vlersiminë e dëmeve të pyjeve të komunës.

Drejtoria ka organizuar trajnime me këshilla nga stafi i certifikuar me fermerët në koordinim me OJQ.

Në tabelë është paraqitur ndarja e subvencioneve për vitin 2022

Emërimi i projekteve për subvencionim	Shuma e subvencioneve
Projekti - “Ngritja e serave tunel 50 m ² për perim-kulturë”.	105,000.00€
Projekti -Vaksinimi i kafshëve kundër sëmundjeve të klostridieve dhe fasciolave,inseminimi artificial i gjedheve ,trajtimin e endometritit dhe atestuesit të gjedheve	42,849.00€
Projekti –Trajtimi i Qenve Endacak	26.250.00€
Projekti – Subvencionim për ujitje	30,000.00€
Projekti-Ndërtimi Minifermave për 5 krerë lopë qumështore	77,394.00€
	176,598.00

-Projekti Furnizim me sera ka filluar .

-Projekti Vaksinimit të kafshëve ka përfunduar ndërsa inseminimi artificial i gjedheve si dhe trajtimi i endometrit dhe atestuesit vazhdon deri ne fund të vitit .Kontratë tri vjeçare .

Projekti trajtimi qenve endacak deri ne fund vitit kontratë tri vjeçare.

Projekti Subvencionimi për ujijtje ka filluar përfundon ne shtator.

Projekti Ndërtimi Minifermave për 5 krerë lopë ne fazën e tenderimit.

Drejtoria e Infrastrukturës Lokale

Drejtoria e Infrastrukturës lokale edhe gjatë javës që po raportojm ka qenë e angazhuar në përgaditjen paramasave dhe projekteve për projekte të ndryshme, mbikqyrje të projekteve dhe shqyrtimi e kërkesave të ndryshme.

Kogjenerimi-Shtrirja e Rrjetit te Sistemit te Ngrohjes Qendrore Obiliq ,ky projekt është trevjeçar,vlera e kontratës është 11,849,684.51€.Deri më tash jan realizuar punime në vlerë 7,943,111.61€.

-Në projektin “Asfaltimi I rrugeve në lagjen Hade e re”,po zhvillohen në rregullimin e Infrastrukturës dhe këtë vit pritet të përfundon projekti.

-Në projektin bashkëfinancim ”Mbindërtimi-Renovimi I Qendres kryesore të mjekësisë familjare në Obiliq” është marrëveshje bashkëpunimi e lidhur në mes të Komunës dhe SH.E.K.”Qëndresa Kosovare” me seli në Prishtinë për renovimin dhe mbindërtimin e objektit të QKMF-ës.

-Në projektin “**Ndërtimi I dy nënkalimeve për këmbësorë**” – jan duke u realizuar dy nënkalime, në nënkalimin afër urës te Kosova B ka përfunduar ndërtimi i punëve të vrazhda, ndërsa te nënkalimi në rrugën Washingtoni jan afër përfundimit punimet e vrazhda. Ky projekt është bashkëfinancim me MAPL-ën .Vlera e kontratës është 429,347.95€.

-Në Projektin “**Asfaltimi i rrugës Migjeni – Raskovë**”,vlera e projektit 48,000.00€.Projekti ka përfunduar në muajin Qershor të këtij viti.

-Në projektin “**Asfaltimi i rrugës Kamer Beka dhe rrugës Dalip Maloku me segmente**”, vlera e projektit 50.000.00€. Projekti ka përfunduar këtë muaj.

-Në projektin “**Ndërtimi i kanalizimit në Lajthishtë**” punimet kan filluar me hapjen dhe pastrimin e rrugëve kadastrale që ka qenë kërkesë e vazhdushme e banorëve dhe pastaj do të fillojm me shtrirjen e rrjetit të kanalizimit.Ky projekt është dyvjeçar,për vitin 2024 jan parapara 100,000.00€, ndërsa për vitin 2025 parashihen edheP 59,666.00€.

-Në projektin **“Ndertimi i Urës në Graboc”** punimet kan filluar dhe po zhvillohen sipas projektit. Projekti është dyvjeçar. Vlera e kontratës 254,965.00€.

-Ne projektin **“Bashkëfinancim me MMPHI-ën-Ndertimi i rruges dhe kanalizimit fekal ne rrugen Avni Rrustemi- Obiliq”** punimet kan filluar dhe po zhvillohen në vendosjen e kanalizimit dhe ujësjellësit dhe pastaj do të vazhdojm me asfaltim.Projekti është dy vjeçar.Vlera e kontratës është 217,170.50€.

--Në projektin **“Bashkëfinancim me MMPHI-ën -Rikonstruimi i trotuarit dhe shtegut për biçikleta në rrugën “Hasan Prishtina” deri te Kosova -A”**, vlera e kontratës është 415,008.25€.

-Në projektin **“Bashkëfinancim me MMPHI-ën -Rikonstruimi i rrugës Dardhishtë-Fushë Kosovë ,Obiliq”** Vlera e kontratës është 663,286.48€.

-Në projektin **“Bashkëfinancim me MAPL-ën - Rikonstruimi i rrugës Obiliq – Mazgit i epërmë”** lënda është ne fazën e vlerësimit te ofertave.

Në projektin **“Bashkëfinancim me MAPL-ën -Ndërtimi i trotuarit në rrugën Daut Hashani dhe rikonstruimi I segmentit të rrugës Vllëzrit Gërvalla”**, vlera e kontratës është 97,900.59€,punimet në këtë projekt kan filluar dhe po zhvillohen sipas projektit.

- Në Projektin **“ Bashkëfinancim me DEMOS-in- Asfaltimi i rrugëve dhe kanalizimi në fshatin Babimoc-** vlera e kontratës është 216,976.29€,punimet në këtë kontratë kanë filluar dhe po zhvillohen sipas projektit.

-Në projektin **“Bashkëfinancim me DEMOS-in -Asfaltimi i rrugëve rurale në fshatin Mazgit”**, vlera e kontratës është 219,795.99€,punimet në këtë kontratë kan filluar dhe po zhvillohen sipas projektit.

Poashtu e kemi nënshkruar edhe një memorandum bashkëpunimi me MAPL-ën, për bashkëfinancimin e projektit **“ASFALTIMI I RRUGËVE ‘PUSHKA E PARË DHE ALI GOLLAKU”** në fshatin Hamidi. Vlera projektit është 69,999.12€. Jemi në fazën e hartimit të projektit detal.

Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Pronë

Drejtoria e DPUPK është e ndarë në katër sektore, sektori i Urbanizmit, Pronës dhe Çështjeve pronësore juridike, Kadastrit dhe Gjeodezisë, ku secili nga këta sektorë është i ngarkuar me punë të natyrave të ndryshme. Të gjithë sektorët janë duke i përmbushur me përkushtim të plotë duke i respektuar normativat ligjore në fuqi dhe afatet ligjore, duke u ndarë të kënaqur edhe me qytetarët edhe me vetë eprorët që vazhdimisht raportojnë për punët e përfunduara dhe ato të cilat janë në proces të përfundimit.

Kështu që puna e kryer gjatë gjashtë mujorit Janar - Qershor ka qenë një punë produktive edhe pse është pjesa e parë e vitit nuk kanë qenë aq voluminoze por si të tilla do t'i paraqesim në vijim :

-SEKTORI I PRONËS-

Gjatë këtij Gjashtë mujori Janar - Qershor **Sektori i pronës** dhe çështjeve pronësore juridike në kuadër të DPUPK-së ka qenë e ngarkuar me punë të natyrave të ndryshme që janë paraparë të kryhen e të cilat do t'i paraqesim në vazhdim :

Drejtoria e Planifikimit Urban Pronë dhe Kadastër përmes shkresës përkatësisht Kërkesës Nr.05-464-01-2792-24 dt.29.01.2024, ka kërkuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit dhënie e pëlqimit për zhvillimin e procedurave të shpronësimit për pronat e caktuara siç janë të specifikuara në shkresë e që janë menaxhim të AKP-së në zonë kadastrale Milloshevë dhe Llazarevë , për shkak se këto njësi kadastrale paraqesin rëndësi të veçantë për zhvillimin e projektit “Ngruhje Diellore Solar4 Kosovo” për të cilin projekt ekziston marrëveshja me Komunën e Prishtinës .

Drejtoria e Planifikimit Urban , Pronë dhe Kadastër me iniciativën e Kryetarit të Komunës pas plotësimit të kushteve ligjore me dt. 11.06.2024 në bashkëpunim me zyrën ligjore ka përpiluar Vendimin Nr.02-104-02-16656-24 për kompensimin e pronarëve të lokaleve afariste “Qendra Tregtare” Obiliq , objekte këto të cilat për shkak të amortizimit të tyre të cilat paraqesin rrezik për qytetarët është dashur të rrënohet dhe një gjë e tillë është rekomanduar edhe nga ana e Raportit komunal .

Gjatë periudhës gjashtë mujore Janar – Qershor 2024 kemi pas kërkesa të lëndëve të ndryshme të cilat bien në kuadër të fushë veprimtarisë së DPUKP-së dhe atë si në vijim:

1.Kontratë e Shitblerjes	110
2.Kontratë për Ndarjen e Paluajtshmërisë	1
3.Aktvendim i Trashëgimisë	21
4.Regjistrim i Hipotekës	21
5.Fshirje e Hipotekës	15
6.Kontrata të Faljes (Dhurimit)	104
7.Parcelizim (Ndarje)	78
8.Bashkim	12

9.Rregullim i Kufijve	2
10.Regjistrim i Objektivit	40
11.Regjistrim Shpronësimi	04
12.Modifikim për Person	77
13.Vendime Gjyqësore	1
14.Kontrata të Qiramarrjes për 99 vite	2
15.Kontrata të Këmbimit (Ndërrimit)	2
16.Vendim Përfundimtarë Qeverisë	2
17.Historiat i Pronës	4
18.Barrë Tatimore	10
19.Bashkim dhe Ndarje e Parcelave	12
20.Vendime për mbajtje të Përjetshme	00
21.Azhurim i Gjendjes në Grafik	10
22.Lirim nga Barra Tatimore	1
23.Urdhër nga Përmbartuesi	1
24.Marrëveshje Ndërmjetësimi	3
25.Regjistrim i vërejtjes gjyqësore	0
26.Fshirje e Vërejtjes Gjyqësore	0

RAPORTI GJASHT MUJOR -2024			
	çertif.paluaajtshmeris	Kopje plani	çertif.gjendj pronsore
kërkesa	566	504	455
te realizuara	553x4	500x4	71x3
Procedurë	0	0	0
me bllok	3	2	0
lirume	10	3	384
totali	2212€	2000€	213€
totali I përgjithshëm	42,321€		

Te Hyrat Vjetore Janar-Mars 2023 në Sektorin e Gjeodezisë Pronë dhe Kadastër janë: 37,896 € + 4425 € Cert.paluaajtshmerisë , Kopje Plani dhe Cert.gjendje pronësore , Gjithsejt të hyra = 28,777 € .

- Numri i Bartjes së Pronës në emër të dy Bashkëshortëve ka qenë 17 ;*
- Numri i Bartjes së Pronës në emër të Burrave 98 dhe;*
- Numri i Bartjes së Pronës në emër të Grave 27 .*

-SEKTORI I KADASTRIT-

- Si piknisje Sektori i Kadastrit kujdeset për respektimin e ligjeve dhe mban përgjegjësi në zbatimin e ligjeve të Kadastrit dhe udhëzimeve administrative të nxjerra nga Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK), dhe se bashku me ta krijojnë metoda në avansimin e metodave të punës.

- Gjatë këtij gjashtë mujori Janar - Qershor kemi punuar në realizimin e të gjitha kërkesave për qytetarët e Komunës, varësisht prej llojit dhe natyrës së kërkesave të qytetarëve.

- Zhvillimin e procedurave të regjistrimit, sipas detyrës zyrtare dhe kërkesës së paleve;

- Korrigjimin e regjistrit në Sistemin Informativ Kadastral të tokave të Kosovës (SIKTK) sipas procedurave dhe zbatimin e të gjitha dispozitave ligjore në fuqi;

- Regjistrimin e pronave të paluajtshme dhe regjistrimin e pronave komunale;

- Azhurimin e pronave në bazë të dokumentacionit të leshuar nga Gjykatat kompetente, Noterët, Përmbaruesit si dhe organet përgjegjëse Vendimet e Kuvendit, Vendimet nga AKK-ja si dhe vendime tjera etj;

- Zbatimin e procedurave rreth transaksioneve të pronave private dhe shoqërore në SIKTK-së ;

- Shqyrtimin dhe kryerjen e procedurave administrative për rikthimin e paluajtshmerisë ish-pronarit, evidentimin dhe shlyrjen e masave të perkohshme sipas aktvendimit të Gjykatës kompetente;

- Udhëheqjen me kadastrë etazhë të banesave, ndërtesave, pjesëve të ndërtesave si dhe ngastrat kadastrale në të cilat janë ndertuar banesat;

- Regjistrimin dhe çregjistrimin e hipotekave ; Aktvendimeve mbi regjistrimin e servituteve, regjistrimin e barrave tatimore;

- Lëshimin e certifikatave personave që nuk kanë patundshmeri, certifikatave mbi të drejtat e pronës së paluajtshme si dhe kopje planit;

- Mirmbajtjen, korrigjimin dhe harmonizimin e evidencave të vendbanimeve, fshatrave, shesheve, rrugëve dhe numrat e objekteve dhe ndërtesave;

- Nxerrjen e aktvendimeve për miratim e ndarjeve të parcelave, bashkimin e parcelave, modifikimin etributeve të parcelave, ndërtesave pjesëve të ndërtesave apo refuzim të kërkesave;

- Nxerrjen e konkluzioneve për plotsimin e kërkesave të pakompletuara;

- Pergaditjen e projektprogramit të punës për nevojat e Drejtorisë dhe raportin punës;

- Punë të tjera në pajtim me dispozitat ligjore (shpalljet publike, kërkesat për nevojat e Kuvendit, të gjykatave dhe institucioneve tjera).

- Zhvillimin dhe organizimin e sistemeve kadastrale, rikonstruimin e informatave kadastrale në formë digjitale, modelin e sistemit informatik për tokën dhe pronën;

- Regjistrimin e ndarjeve të parcelave dhe modifikimin etributeve të parcelave, ndërtesave dhe pjesëve të ndërtesave.

- Kryerjen e punëve profesionale, të cilat dalin nga shërbimi gjeodezik (ndryshimet e bërë gjatë matjeve nga Hartat e Kosovës dhe bartjen e tyre në programin e SIKTK-së.

- Kryerjen e shërbimeve për shënimet e digjitalizuara (dhenien e kordinatave për teren);

- Si dhe Shërbime profesionale dhe shërbime të tjera, për subjekte dhe institucione të ndryshme;

- Si dhe për fund kemi marrë pjesë në trajnime, seminare të ndryshme për zhvillimin e njohurive që të jemi sa më transparent në kryerjen e shërbimeve ndaj qytetarëve të Komunës.

- Në përfundim të këtij raporti për gjashtë mujorin Janar - Qershor konstatojmë se kemi arritë t'i përfundojmë varësisht prej natyrës së lëndëve, Kontrata të ndryshme, ndarje të parcelave, bashkimin e parcelave, modifikimin etributeve të parcelave, ndërtesave pjesëve të ndërtesave apo refuzim të kërkesave Vendime të ndryshme etj.

-SEKTORI I GJEODEZISË-

Raporti përmban një përmbledhje në vijë të trasha të punëve gjatë periudhës gjashtëmujore për vitin 2024. Në raport do të përfshihen punët e përfunduara nga sektori në aspektin profesional sipas kërkesave të parashtruara nga ana e drejtorive të KK Obiliq të cilat lidhen drejtpërdrejt me punë profesionale në teren e që janë situacione të ndryshme për nevoja të projektimit, matje të parcelave – kufijve për ndërtimin dhe planifikimin e rrugëve, elaborate të shpronësimit dhe identifikime të ndryshme me matje.

Në cilësinë e anëtarit të komisionit për caktimin e kushteve ndërtimore ka pas pak aktivitet për shkak të mungesës së kërkesave për leje ndërtimore pasi që hartat zonale ende nuk janë përfunduar. Pasqyra e lendeve të përfunduara në kuadër të mirëmbajtjes së rregullt të kadastrit do të paraqitet me një tabelë të veçanta dhe do të bashkëngjis këtij raport. Ndërsa ky raport me shkrim do të përfshijë vetëm punët dhe shërbimet që janë kryer sipas kërkesave të Drejtorive brenda Komunës. Gjatë periudhës gjashtëmujore 2024 është punuar shumë në legalizimin e objekteve sipas ligjit për legalizim, objektet të cilat marrin Vendimin për Certifikatë të Legalizimit rexhistrohen në pjesën grafike dhe tekstuale të Kadastrit në këtë proces janë legalizuar objekte në baze të Vendimit për Certificate të Legalizimit gjithsejtë sipas zonave kadastrale me sa vijon:

- zk Babimoc.....2 (dy) objekte
- zk Krushevc.....3 (tri) objekte
- zk Mazgit.....10 (dhjetë) objekte
- zk Milloshve.....14 (katërmëdhjetë) objekte
- zk Obiliq.....9 (Nëntë) objekte
- zk Plemetin.....1 (një) objekt
- zk Llazarevë.....1 (nje) objekt

Gjithësejt **40 objekte** të rexhistruara në kadastrë në procedurë të legalizimit dhe procedurë të rregullt në baze të lejes ndërtimore dhe aktvendimit për certificate të përdorimit.

Me kërkesën e Drejtorisë së Infrastrukturës gjatë periudhës gjashtëmujore janë kryer punë nga lëmia e gjeodezisë inxhinierike dhe fusha e kadastrit, si matje për kanalizime dhe përcaktim të kufijëve të rrugës për punim. Ka pas mjaft aktivitetesh pune me përfaqësuesit e KEK-ut për përcaktimin e rrugës qarkore pasi që rruga ekzistuese është atakuar nga zgjerimi i minierës. Lëndët e punuara në pjesën grafike në mirëmbajtjen e rregullt të kadastrit

-SEKTORI I URBANIZMIT-

-Gjatë periudhës janar-qershor 2024 sektori i **urbanizmit** në kuadër të DPUPK ka qenë i ngarkuar me punë të natyrave të ndryshme që kanë qenë të paraparë me planprogram si ato në zgjidhjen e kërkesave të palëve, përgjegjësit brenda Komunës, pjesëmarrjet në takime jashtë komunës, pastaj trajnimet e ndryshme, e shumë punë të tjera të lidhura me këtë sektor, ku të gjitha këto fushëveprime janë përmbyllur me sukses gjatë këtij gjashtëmujori.

-Plotësimi I formularëve të performancës kërkesë nga komisioni komunal i performancës.

-Pjesëmarrja në trajnimin nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës lidhur me procesin e fillimit të Hartimit të Planit Hapësinor të Kosovës.

-Pjesmarrja në trajnimin e organizuar nga OSB-eja lidhur me procedurat e paisjes apo mos paisjes me vendim të legalizimit, si dhe vështërsit e hasura në procedurat e paisjes me vendime të legalizimit.

-Takime pune me MMPHI lidhur me problemet që kemi hasur lidhur me Hartimin e Hartës Zonale bashkarisht me Institutin e Planifikimit si dhe Ministrin linja që kanë të bëjnë me HZK-në.

Gjatë hartimit të këtij dokumenti qëllim kryesor ka qenë që të gjejmë zgjidhje për qytetarët tanë, duke u munduar të bëjmë zgjedhjen kryesore çështjen e banimit, duke ditur se Komuna e jonë është mbi 70% zonë e interesit të veçantë, është problem sigurimi për çështjen e banim dhe plotësimin e nevojave qoftë primare, sekondare e besa ndoshta edhe të atyre elementare. E vetmja Zonë e cila ka qenë e paraparë për vendosjen e banorëve nga Zonat e Mihjeve Sipërfaqësore ka qenë Lokacioni në Shkabaj në lagjen “Hade e e Re”,

Mirëpo tani as këtë lokacion nuk e kemi sepse me Projektin e Bankës Botërore në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës për “Solar 4”, ky projekt është vendosur në këtë Lokacion, që dmth të vetmen mundësi për banorët e zhvendosur më nuk e kemi.

Jemi munduar që ta shfrytëzojmë mundësin për dendësin më të madhe, pasi kryesisht interesimi i banorëve të zhvendosur është drejt qendrës së qytetit, prandaj duhet të merret parasysh kjo çështje që të mos ketë barriera në zhvillimin e qytetit sa i përket ndërtimeve të larta, pasi si zgjidhje e vetme dhe e mundëshme është kjo mundësi.

Në kuadër të këtij projekti Komuna e Obiliqit ka formuar komision profesional të përbërë nga anëtarë të të gjitha drejtorive të KK Obiliq si dhe duke kyçur edhe aktorët tjerë që janë të atakuar me këtë projekt.

Kemi filluar me punë nga korrik I vitit 2021 duke vazhduar me takime të njëpasnjëshme e duke kaluar nëpër çdo fazë të përcaktuar me ligj.

-Kemi organizuar takime me qytetarë duke filluar nga zona urbane dhe kemi vazhduar edhe në zonat rurale. Së pari kemi bërë njoftime për qytetar që ata të jenë të njoftuar për takimet, në mënyrë që të jenë prezent dhe së bashku ti përcaktojmë detajet dhe normat e zhvillimit në tërë teritorin e Komunës sonë së bashku me qytetarët.

Pas takimeve të njëpasnjëshme me qytetarë dhe harmonizimit të mendimeve me ta, Komuna e Obiliqit ka pasur edhe një takim me të gjitha biznese e Komunës duke filluar nga bizneset e vogla deri te ato të mëdha, ku përmes njoftimit publik ju ka bërë ftesë bizneseve të cilat i'u kanë përgjigjur kërkesës tonë masivisht dhe pjesëmarrja ka qenë mjaft e madhe nga ta.

Duke ditura se në Komunën tonë kemi KEK, KEDS, KOSST, pastaj zonën industriale ku janë të koncentruar një numër i madh i biznesesve nga të gjitha anët e poshtu edhe kompani të jashtme, ka qenë nevojë e domosdoshme një takim i tillë, sepse harmonizimi i interesave të përbashkëta me ta do të jetë një përfitim i madh si për komunën tonë ashtu edhe për qytetarët e saj.

Kemi përgatitur edhe raportin e VSM-së, projekt në kuadër të HZK-së të cilin e kemi prezantuar para qytetarëve. Ky projekt ka qenë 30 (tridhjetë) ditë në shqyrtim publik dhe pasi nuk pati vërejtje, sygjerime apo ndonjë koment nga qytetarët apo grupet tjera të interesit, dokumenti është kompletuar dhe dorëzuar për shqyrtim në MMPHI-në, për të na paisur me pëlqim për të vazhduar më tutje në draftimin final të dokumentit të Hartës Zonale.

Komuna ka marrë Vendimin për Pëlqim Mjedisor për Raportin për Vlerësim Strategjik Mjedisor për Hartën Zonale për Komunën e Obiliqit më datën 08.02.2024 me numër protokoli 5380-2/23 nga MMPHI-ja.

Njëkohësisht rreth këtij dokumenti Komuna jonë ka organizuar një punëtori treditore në Republikën e Shqipërisë, respektivisht në Pogradec me pjesëmarrjen e anëtarëve të MMPHI-së, anëtarët e MBZHR, si dhe prezencën e Kryetarit të Komunës, kompaninë projektuese, komisionin komunal të komunës.

Kjo punëtori ka qenë mjaft produktive sepse i është dhënë kahja përfundimtare draftimit të këtij dokumenti duke u inkorporuar të gjitha pikat kyçe bashkërisht me Ministrin e linjës në mënyrë që ky dokument të finalizohet sa më shpejtë.

Kërkesë e përfaqësuesve të Ministrisë së MPHI ishte që të respektohet rregullativa ligjore si dhe të arsyetohet çdo veprim i marrë në dokument.

Tani kemi arritur në fazën përfundimtare ku pas një pune voluminoze me takime, prezentime para qytetarëve para grupeve të interesit, duke u munduar që çdo cep si të Zonës Urbane po ashtu edhe të asaj rurale të analizohet dhe të mundohemi që këtij dokumenti t'i japim një orientim sa më konkret dhe të zbatueshëm për qytetarët duke u bazuar në norma të planifikimit. Shpresojmë të kemi arritur që dokumenti të jetë i zbatueshëm në teren duke plotësuar nevojat e qytetarëve, duke respektuar rregullat e përcaktuara në bazë të Normave të Planifikimit. Dokumenti është dorëzuar në MMPHI për marrjen e Vendimit për Pëlqim për hapjen e diskutimit publik.

-Si dhe shumë punë të tjera që janë të lidhura me sektorin e urbanizmit, duke cekur edhe konsultimet me palë lidhur me punët që I takojnë natyrës së punës tonë.

-Më poshtë do të cekim lëndët që janë të lidhura me të hyrat në sektorin tonë.

- 5 vendime për leje ndërtimore,
- 3 certifikata të përdorimit,
- 1 vendim të refuzimit,
- 1 leje rrënimi,
- 34 përgjigjeje palëve,
- 5 njoftime për qytetarë në kërkesat e ndryshme.

- 40 vendime të legalizimit të objekteve

- 7 vendime të legalizimit për listë të pritjes.

Të hyrat nga lejet ndërtimore : 760.00 euro
Të hyrat nga legalizimi i objekteve: 3 404.76 euro

TOTAL 4 164.76 EURO

Sektorin e Urbanizmit :	4 164.76 €
Sektorët - Gjeodezi Pronë dhe Kadastër :	42,321 €
Totali :	46,485€

NJËSIA E BURIMEVE NJERËZORE

Duke u mbështetur në planifikimin e burimeve njerëzore si dhe planin e punës për vitin 2024 Njësia e Burimeve Njerëzore ka për qëllim zbatimin e planit të punës.

Plani i punës për vitin 2024 përmban bazën ligjore, strukturën organizative të Njesisë së Burimeve Njerëzore (NJBNJ), detyrat, përgjegjësit objektivat të cilat realizohen përmes aktiviteteve, indikatorëve, përgjegjësve dhe afateve kohore. Kjo mundëson zbatimin më të lehtë të këtij plani dhe monitorimin e tij.

Gjatë muajit Janar /Qershor / 2024 kemi zhvilluar këto procedura :

-Planifikimi i personelit për vitin 2024.

-Vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2023

Emërimet

Mars / Emërohet UD i drejtorit të DA Ibush Mjekiqi nga data 11.03.2024 deri me dt 20.06.2024

Emërohet UD i drejtorit të D. Inspektionit Arben Berisha nga data 21.06.2024. deri në zgjedhjen e drejtorit .

Emërohet drejtor në DSHPE Naim Miftari nga data 24.06.2024

Emërohet Drejtor në MM Abdyrrahman Krasniqi nga data 24.06.2024

Emërohet Drejtor në D për Arsim Fitore Hashani nga data 24.06.2024

-Shkarkimet

-Mars / Shkarkim nga detyra Sahit Zeqiri 08.03.2024

-Qershor / shkarkim nga detyra e drejtorit të Inspektionit Naim Miftari nga data 21.06.2024,

- shkarkim nga detyra e drejtorit të DSHPE-së Abdyrrahman Krasniqi nga data 21.06.2024,

- shkarkim nga detyra e drejtorit të të MM Fitore Hashani nga data 21.06.2024

Pensionim :

Zyrtari për paga

- Rekrutim – Pranim nga jashtë :

-Zyrtar i logjistikës i hapur me në proceduar të ankesës .

-Zyrtar ligjor në procedurë .

-Auditor i brendshëm në procedurë.

-Zyrtar për shërbime sociale në procedure të ankesës .

-Zyrtar për pasuri në procedura të ankesës .

Transferim i përhershëm : 2

-Transferim i përkohshëm :1

-Klasifikimi i vendeve të punës sipas Ligjit të ri të pagave Shkurt /2023 dorëzimi i listave për ndryshim të pagës në MF për zyrtarët publik të cilët janë korrigjuar nga MPB/DMZP lista e dt.20.12.2023, lista e dt.29.12.2023 lista e dt.12.02.2024 .

-Përgjigje në Ankesat e paraqitura në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës 9

Janar tetë ankesa / rritje të koeficienteve 9

-Listat e pagave për administratë, shëndetësi dhe arsim / printimi nga sistemi i pagesave, nënshkrimi nga të gjithë të punësuarit, kontrollimi dhe barazimi me DBF për administratën komunale

-Ndryshimet në lista të pagave .

Përgatitja e formularëve dhe dërgimi i formularëve në sistemin e pagesave MF për secilin muaj.

-Pagesa /Lista elektronike e anëtarëve të Kuvendit Komunal, Komitetit për politik dhe Financa, Komitetit për Komunitete, komitetit për auditim ,

-formular për ndryshime

- formular retroaktiv

- formular transfer bankar

-Letër konfirmim për paga, konfirmim bankar, kalkulatori për llogaritje punë jashtë orarit .

Raport i punës për periudhën vjetore Janar-Qershor 2024

Gjatë këtyre muajve kemi zhvilluar këto procedura.

- **Rekrutim – Pranim nga jashtë :**

Gjatë muajit Janar-Shkurt janë përfunduar procedurat e rekrutimit për konkurset e hapura gjatë muajit dhjetor 2023, gjithsej 8 konkurse prej tyre 4(katër) konkurse kanë përfunduar me sukses ndërsa 4 (katër) konkurse janë anuluar.

- **Konkurse:**

Për periudhën Janar-Qershor 2024 kemi pasur gjithsej 7 konkurse:

- **Rekrutime / Lëvizje brenda kategorisë :**

Nuk kemi pasur lëvizje brenda kategorisë..

- **Punëtor jashtë listës së pagave:**

Nuk kemi

- **Marrëveshje për shërbime të veçanta:**

Nuk kemi

- **Planifikimi i personelit:**

Planifikimi i personelit është i ngarkuar në SIMBNJ

- **Ngritje në detyrë :**

Gjatë kësaj periudhe nuk kemi pasur ngritje në detyrë.

- **Përfundim i periudhës provuese :**

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur punëtor që në bazë të nenit 10 pika 5 të Ligjit të Punës nr.03/L-212 mbi përvojën e punës 10 vjeçare kanë fituar të drejtën e kontratës së përhershme dhe disa kanë përfunduar periudhën provuese si më poshtë:

- **Autorizim për zëvendësim :**

Nuk kemi.

- **Klasifikimi i vendeve të punës:**

sipas Ligjit të ri të pagave dorëzimi i listave për zyrtarët publik në MPB/DMZP .

- **Ankesë e brendshme :**

Nuk kemi.

- **Ankesa në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës :**

Nuk kemi.

- **Komision Disiplinor :**

Kemi 3 Raste prej tyre një është kthyer në DA te Komisioni i Ankesave sepse është e pabazuar për të vazhduar tutje nga Komisioni Disiplinor, ndërsa, dy raste të tjera jemi në procedurë e sipër.

- **Pushime :**

Pranimi i kërkesave për pushime dhe mbajtja e evidencave për të gjithë punonjësit.

- **Listat e pagave:**

pranimi dhe dorëzimi tek drejtorët e institucioneve arsimore, nënshkrimi nga të gjithë të punësuarit, kontrollimi dhe barazimi me DBF për Drejtorinë e Arsimit.

- **Largime** kemi pasur 13 të larguar prej tyre (6) gjashtë pensionist dhe (7) gjashtë të tjerë që kanë qenë zëvendësime të pushimeve të lehonisë.

Zyra ligjore

Zyra ligjore për periudhën gjashtë mujore (Janar-Qershor 2024) paraqet këtë raport të punës:

Shërbimet ligjore të ofruara:

-**Këshilla juridike** ,për të gjitha drejtoritë komunale ,auditorin e brendshëm,zyrën e personelit në përpilimin e akteve juridike ,vendime ,procedurat e shpronësimit,rregulloret komunale të aprovuara në kuvend sipas propozimeve të drejtorive .

-Përpilimin e kontratave ,memorandumeve për zyrën e kryetarit dhe për të gjitha drejtorite ,shkresave të ndryshme etj.si:

1.Marreveshjen e Bashkepunimit për shfrytëzimin e palestres sportive „Adem Jashari“ ne obiliq me Federatën e Hendbollit të Kosovës.

2.Plotësim ndryshimin e Kontratës me nr.II-225 të dt.14/03/2023 për dhënjen në shfrytëzim të mjeteve makinerike të punës me NPL“ Kastrioti“ SHA.

3.Marrëveshje në mes të komunës së Obiliqit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame në Obiliq për shërbimet e varrimit.

4. Kontrollimi i Marrëveshjes për Qendren Tregëtare në Obiliq si dhe shqyrtimi i vendimit,

5.Memorandumi i Mirëkuptimit në mes të Internacional OJQ dhe Komunës për Drej.e Arsimit.

Poashtu dhe shqyrtimin e kontratave të propozuara nga ana e drejtorive dhe organizatave të ndryshme.

-Përpilimin e venimeve sipas kërkesës së Kryetarit dhe Drejtorive

1.Kontrollimi dhe shqyrtimi i Draft Statutit të Ansambllit të këngëve dhe valleve në Obiliq.

2. kontrollimi i Rregullores (KO) Nr. ____ Për Organizimin e Punës në Shkollat Filllore të Mesme të Ulta dhe të Mesme të Larta ,Udhëheqësit,Mësimdhënësit,Nëpunësit pProfesional,Mbështetës,Nxënësit dhe Masat Disiplinore.

Përfaqsimet :Në bashkëpunim me avokatin janë bërë mbi **520 veprime** juridike –gjqëaore duke përfshirë ,padit shkresa ,përgjigje në padi,parashtresa të ndryshme për gjykatë , mbajtje të seancave gjyqësore , sigurim të provave sipas kërkesës së gjykatave,prapsime tek permbaruesi,menaxhimi i kontratës së avokatit ,kontrollimin e të gjitha aktgjykimeve dhe vendosjen e tyre ne dosje sipas numrave rendor dhe veprime tjera.

-Përcjelljen e ligjeve ,Rregulloreve dhe udhëzimeve administrative përmes ueb faqeve të Kuvendit të Republikës Kosovës dhe Qeverisë.

-Pjesmarrje ne takimet e rregullta të kolegjiunit të zyrtarëve ligjor në kuadër të Asociacionit të Komunave të Rrepublicës së Kosovës

-Hartimi i raportit për shpenzime kontigjene për auditorin gjeneral, jane marre si moster 11 lëndë gjyqësore te cilat jane sqaruar nga ana e z. ligjore

-Këshilla për zbatimin e ligjeve, rregulloreve dhe udhezimeve administrative të cilat vijnë nga niveli qendror,sipas kërkesave të drejtorive .

-Pjesmarrje në mbledhjet e komitetit për politikë dhe financa dhe mbledhjet e Kuvendin e Komunes ku në bashkëpunim me sekretarinë e Kuvendit dhe me kryesuesen bëjmë përpilimin e akteve të ndryshme nga fushëveprimtaria e kuvendit komunal,

-Takime të rregullta me Avokatin e Komunës ,bashkëpunim dhe koordinim të punës në çështjet gjyqësore,përpilimin e përgjigjeve në padi dhe shkresa tjera,sigurimin e provave nga ana e drejtorive përgjegjëse për secilën lëndë që i përket atyre ,pjesmarrje në seanca gjyqësore dhe

çështje tjera që kanë të bëjnë me të gjitha lëndët gjyqësore ne cilësinë e palës paditëse dhe të paditur.

Njësi Antidiskriminim dhe Barazi Gjinore

Mekanizmi Koordinues Komunal Kundër Dhunës në Familje (MKKKDHF) në Komunën e Obiliqit ,është themeluar me qëllim që të sigurojë një reagim të menjëhershëm dhe gjithpërfshirës ndaj dhunës në familje, koordinim efikas të reagimit institucional për adresimin e rasteve të dhunës dhe të kontribuojë në krijimin e politikave proaktive kundër dhunës në familje në Komunën e Obiliqit.

Objektiv e këti mekanizmi është marrveshja e Mirëkuptimit ndërmjet Autoriteteve përgjegjëse në komunën e Obiliqit, për trajtimin e çështjeve të dhunës në mardhënjet familjare perms institucionalizmit të Mekanizmit Kordinues (MK).

Baza ligjore

1.1.Marrëveshja e Mirëkuptimit bazohet në Ligje dhe akte tjera si në vijim:

- 1.1. Ligjin nr. 0/3-L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 76, datë 10.08.2010);
- 1.2. Ligjin nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28, datë 04.06.2008);
- 1.3. Ligjin nr. 04 L- 017 për Ndihmë Juridike Falas (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 3, datë 22.02.2012),
- 1.4. Ligjin nr. 03/L-057 për Ndërmjetësim,(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 41, datë 01.11.2008);
- 1.5. Ligjin nr 05/L-020 për Barazi Gjinore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 16, datë 26.06.2015)
- 1.6. Ligjin nr 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 17, datë 16.09.2011);
- 1.7. Ligjin nr **2004/4** për Shëndetësinë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 16, datë 01.08.2007) dhe Ligji nr. 03/L-124 për ndryshimin dhe Plotësimin e e Ligjit për Shëndetësi (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 46, datë 15.01.2009);
- 1.8. Ligjin nr. 04/L-083 për Regjistrimin dhe Evidencën e të Papunësuarve dhe Punëkërkesve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 12, datë 15.05.2012);
- 1.9. Ligjin nr. **2004/32** për familjen i Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 04, datë 01.09.2006);
- 1.10. Ligji nr. 05/L-036 – për kompenzimin e viktimave te krimit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 19, datë 13.07.2012);

- 1.11. Kodi nr. 04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 17/2015, datë 30.06.2015);
- 1.12. Kodi nr./03-L-193 i Drejtësisë për të Mitur (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 78, datë 20.08.2010) dhe
- 1.13. Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Kundër Dhunës në Familje, së bashku me Planin e Veprimit për Dhunën në Familje etj.
- 1.14. Procedurat standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje në Kosovë, Zyra e Kryeministrit- Agjensia për barazi Gjinore;
- 1.15. Udhëzimi Administrativ 12/2012 i datës 06.11.2012, për përcaktimin e vendit dhe mënyrës së trajtimit psikosocial të kryesit të dhunës në familje dhe
- 1.16. Udhëzimi Administrativ 02/2013 i datës 15.02.2013, për trajtimin e obligueshëm mjekësor të kryesit të dhunës në familje nga varësia prej alkoolit dhe substancave psikotrope.

Raporti i rasteve të dhunës në familje në mënyr tabelare Janar-Qershor 2024

1.	Numri i rasteve të proceduara në prokurori	35
2.	Numri i rasteve që kanë has në mirkuptim në mes palve	0
3.	Numri i rasteve në strehimore	6
4.	Numri i rasteve të dhunës në total	39

Përkastësia Gjinore :

Femra__ 30 Meshkuj_9

Përkatësisë etnike:

shqiptar _31_, serb_0, turq 0 boshnjak_0, rom_6__, ashkali__2, egjiptian_0,malazez--0

e të tjerë, dhe c) aftësisë së kufizuar.